

BAROMETRI PËR MUNDËSI TË BARABARTA

Shkup, 2019

**BAROMETRI
PËR MUNDËSI
TË BARABARTA**

Shkup, 2019

Publikim: Barometri për mundësi të barabarta
Redaktore: Dr. Zhaneta Poposka
Autor: Gjorgji Kimov, Fani Kimova
Përkthim në gjuhën shqipe: Almedina Xhaferi, Bukurie Mustafa
Disenji dhe përpunimi teknik: Koma lab.
Shtyp: Polyesterday
Tirazhi: 300 ekzemplarë

CIP - Katalogizacija во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.647.82:316.654(497.7)"2009/18"(047)

КИМОВ, Ѓорѓи

Барометар за еднакви можности : извештај / автор Ѓорѓи Кимов. -
Скопје : ОБСЕ, 2019. - 100, 100 стр. : илустр. ; 24 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Barometri për mundësi të barabarta :
raport / Gjorgji Kimov. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни
насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - фусноти кон текстот. - Содржи и:

Прилог

ISBN 978-608-4788-37-9

а) Дискриминација - Јавно мислење - Македонија - 2009-2018 - Извештаи
COBISS.MK-ID 111401738

OSBE Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Tabela e përmbajtjeve

Hyrje	1.	2.	3.	4.
	Vendosja e kontekstit	Perceptimi i diskriminimit	Përvojë me diskriminim	Përvojat dhe perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë
7-11	12-22	23-50	51-61	62-67
	<p>1.1 A keni mik/e apo të njohur/a të cilët janë anëtarë të një grupi/grupeve të caktuara?</p> <p>1.2 Në vendbanimin tuaj, a e konsideroni veten t'i përkisni një pakice të caktuar?</p>	<p>2.1 Niveli i perceptimit të diskriminimit</p> <p>2.2 Niveli i perceptimit të diskriminimit në afat të mesëm</p>	<p>3.1 Përvojë personale me diskriminim</p> <p>3.2 Dëshmitar i dikujt që përjeton diskriminim</p>	<p>4.1 Përvoja personale me diskriminim të shumëfishtë</p> <p>4.2 Përvojë në diskriminim të shumëfishtë të të tjerëve</p> <p>4.3 Perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë</p>

5 .	6 .	7 .	8 .	Shtojca
Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta të punësimit 58	Lufta kundër diskriminimit	Njohja e të drejtave dhe kërkimi i mbrojtjes në rast diskriminimi	Përfundim	
68-76	77-78	79-85	86-90	91-103
<p>5.1 Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta të punësimit</p> <p>5.2 Mbështetje për masat të cilat sigurojnë mundësi të barabarta në punësim</p> <p>5.3 Mbështetja e masave të mbikqyrjes së punës në vend</p>	<p>6.1 Vlerësimi i përpjekjeve për luftën kundër diskriminimit</p>	<p>7.1 Njohja e të drejtave dhe kërkimi i mbrojtjes në rast diskriminimi</p> <p>7.2 Gatishmëria për të adresuar institucionet relevante në rast të diskriminimit</p>		<p>Shtojca 1 - Metodologjia e aplikuar në hulumtim</p> <p>Shtojca 2 - Pyetësi i hulumtimit</p> <p>Shtojca 3 - Shpërndarja e karakteristikave socio-demografike relevante të të anketuarëve/ave</p>

Diskriminimi si fenomen global ka efekt negativ mbi të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Ai nxit përjashtimin, marginalizimin dhe dehumanizimin. Për këtë arsye, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimi është baza e të drejtave dhe vlerave themelore që janë identifikuar si thelbësore nga shumica e organizatave ndërkombëtare dhe të instrumenteve ligjore. Për shkak se në vend munguan rregulloret ligjore mbi të cilat vendoset mbrojtja nga diskriminimi dhe realizimi i së drejtës së trajtimit të barabartë deri në vitin 2010, solli miratimin e *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*¹, zbatimi i të cilit filloi nga 1 janari i vitit 2011. Ky është ligji i parë në vend, që përpiqet të trajtojë diskriminimin në një mënyrë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse dhe me të parashihen mekanizma të reja për mbrojtje. Institucionet relevante me kompetenca të përcaktuara ligjërish në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe ushtrimi të drejtës për trajtim të barabartë janë:

- ▶ Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi;
- ▶ Avokati i Popullit;
- ▶ Gjykata Kushtetuese;
- ▶ Gjyqet;
- ▶ Përfaqësues për mundësi të barabarta për meshkujt dhe femrat;

Përvoja, jo vetëm në shtet por edhe në Bashkimi Europian, tregon se kërkesa për të drejta të barabarta dhe miratimi i ligjeve për promovimin dhe mbrojtjen e tyre, nuk është e mjaftueshme për të siguruar në praktikë, që të gjithë të gëzojnë të drejta të barabarta. Përvojat e tilla në vend, kanë nxitur iniciativa për një luftë më të përgjithshme kundër diskriminimit. Në pajtueshmëri me qasjen e re, u zhvilluan tri hulumtime të opinionit publik në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2018. Qëllimi i këtyre hulumtimeve është të sigurojë të dhëna empirike mbi perceptimin dhe përvojat e qytetarëve në fushën e diskriminimit dhe mbështetja e masave për luftimin e diskriminimit në përgjithësi. Ndejkja e këtyre tendencave në publik, në të njëjtën kohë paraqet mjet të dobishëm, i cili ndihmon për të pasur njohuri, jo vetëm në përgjithësi, por edhe në mesin e ekspertëve që merren me këto probleme.

¹ Gazeta Zyrtare nr. 50/2010 botuar më 13.04.2010.

Hulumtimi i parë është realizuar në prill të vitit 2009, para miratimit të *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi* dhe për këtë arsye paraqet bazë për krahasimin e perceptimeve, qëndrimeve, njohurive dhe ndërgjegjësimit mbi diskriminimin dhe pabarazinë në publikun vendas, në aspektin e gjetjeve që kanë sjellë dy hulumtimet e ardhshme të realizuara në vitin 2013 dhe 2018. Rezultatet e dy hulumtimeve të fundit pasqyrojnë ndryshimet pas miratimit të *Ligjit* dhe zbatimit të tij.

Duhet të theksohet se për shkak të qasjes së ndryshme të hulumtimeve, mundësitë për analizë krahasuese ishin të kufizuara. Në hulumtimin e vitit 2013, si mënyrë e mbledhjes së të dhënave është përdorur „intervista përmes telefonit“, krahasuar me hulumtimet në terren të vitit 2009 dhe 2018, ku është përdorur metoda „ballë për ballë“ në shtëpinë e të anketuarit. Gjithashtu në hulumtimin e vitit 2013 janë bërë ndryshime në rradhitjen e tekstit të pyetësorit (për më shumë detale shikoni Shtojcën 1 - Metodologjia e aplikuar në hulumtim). Për shkak të mos qasjes në bazën e të dhënave të studimit të zhvilluar në vitin 2013, raporti në disa vende tregon vetëm krahasimet midis rezultateve të anketave të vitit 2009 dhe 2018.

Në këtë raport janë analizuar zbulimet nga anketa „Barometër për mundësi të barabarta“, e cila u zhvillua për herë të tretë, në shtator të vitit 2018, nga Brima Gallup International.

Analiza krahasuese e rezultateve të tria hulumtimeve mundëson njohuri mbi drejtimin dhe intensitetin e ndryshimeve në perceptimet, qëndrimet, njohuritë dhe në ndërgjegjësimin mbi diskriminim dhe pabarazinë në shtet në periudhën prej vitit 2009 deri më 2018. Në raport analizohen përgjigjet e të anketuarëve/ave për shtatë baza të diskriminimit: gjinor, në bazë të përkatësisë kombëtare, të religjionit apo të bindjes, moshës, aftësisë së kufizuar, të orientimit seksual apo të përkatësisë politike.

Raporti ilustron edhe intensitetin e ndryshimeve, të cilat janë arritur gjatë periudhës së hulumtimeve 2009-2018 dhe identifikon pikat ku rezistenca ndaj ndryshimeve është më e theksuar.

Raporti sipas temave dhe disa çështjeve që i përfshinë, ka strukturën vijuese:

- ▶ Kontekstin social të të anketuarëve/ave, dhe vetëidentifikimin e tyre si anëtarë të një grupi të pakicave /të diskriminuar;
- ▶ Perceptimet e llojeve të ndryshme të diskriminimit, diskriminimi i shumëfishtë si dhe qëndrimet ndaj grupeve të ndryshme të ndjeshme ndaj diskriminimit;
- ▶ Perceptime personale diskriminuese të të anketuarëve/ave dhe /ose si dëshmi të përvojave diskriminuese të dikujt tjetër;
- ▶ Vlerësimet e të anketuarëve/ave për përpjekjet e shtetit për të luftuar diskriminimin; Tregon nivelin e njohurive të të drejtave nga viktimat potenciale të diskriminimit; dhe
- ▶ Mendimet mbi barazinë e mundësive gjatë punësimit në shtet.

Gjatë prezantimit dhe analizimit të gjetjeve për temat e hulumtuara, janë bërë krahasime mes nëngrupeve të ndryshme të të anketuarëve/ave, të definuara sipas karakteristikave vijuese socio-demografike: gjinisë, moshës, nivelit të arsimit, përkatësisë kombëtare e religjioze dhe politike, vendbanimit (urban/rural) dhe përkatësisë rajonale.

Për shkak të kontekstit specifik socio-politik në shtet që në hulumtimin fillestar të vitit 2009, përveç gjashtë kategorive² bazë të diskriminimit të zbatuar në Eurobarometrin Special të vendeve të Bashkimit Europian, është shtuar kategoria e diskriminimit në bazë të përkatësisë

2 Gjashtë bazat e diskriminimit të shqyrtuara në Eurobarometrin special janë: diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, besimit fetar apo besimit dhe personave me aftësi të kufizuara.

3 Rezultatet e hulumtimit tregojnë se për shumicën e popullsisë, përkatësia politike është baza më e përhapur për diskriminim, e cila perceptohet si një faktor kyç në procesin e përzgjedhjes së punësimit.

politike⁴. Kur „lexohen” rezultat e hulumtimit të vitit 2018, duhet të merret në konsideratë klima politike e përmendur gjatë së cilës u realizua hulumtimi. Puna në terren u realizua gjatë një momenti historik shumë të rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Më 30 Shtator ishte i planifikuar një referendum mbarëkombëtar⁴ në të cilin qytetarët/et duheshin të shprehnin pikëpamjet e tyre mbi të ashtuquajturën “Marrëveshje të Prespës”, i cili duhet t’i japë fund mosmarrëveshjes me Greqinë fqinje mbi emrin e vendit. Hulumtimi në terren, filloi dy ditë përpara fushatës zyrtare kombëtare të referendumit në periudhën prej 7 shtatorit deri më 27 shtator. Megjithatë, rezultatet nuk tregojnë ndryshime të papritura në tendencat, që mund të tregojnë ndonjë ndikim nga fushata e referendumit.

Në raport janë prezantuar vetëm të dhënat, për të cilat ka një nivel relevant statistikor.

⁴ Qytetarët/et duhej të vendosnin nëse pranojnë ose nuk e pranojnë të ashtuquajturën “Marrëveshje e Prespës” si një kusht për t’u bashkuar me BE-n dhe NATO-n

P ë r m b l e d h j e

5 Boris Petz, Osnovne statističke metode za namatematičare, SNL, Zagreb, 1981, faq. 278: Në statistikë termi „dukshëm” nuk do të thotë „e madhe” mirëpo ka kuptimin se „nuk është fituar rastësisht”. Përveç kësaj, Čedomir Dragičević, Statistika za psihologe Društvo psihologa, Srbije, Beograd, 1991, стр. 189: „Veprimet e përfundimit statistikor me ndihmën e të cilët është e mundur të testohen diferencat e fituara në rezultate, quhen metoda për kontrollim të rëndësisë së diferencave ndërmjet masave statistikore. ... Statistika mundëson të vërtetohet me probabilitet të lartë (prej 95% përkatësisht 99%) nëse ekziston ose nuk ekziston me të vërtetë dallim mes të dhënave të fituara.”

H u l u m t i m e t e zhvilluara në periudhën nga viti prej 2009 deri 2018 tregojnë që sipas perceptimit të publikut diskriminimi është shumë më i përhapur, në krahasim me perceptimin se nuk ekziston. Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe etnike konsiderohet se është më i përhapur. Ky konstatim lidhet ngushtë me perceptimin e të anketuarëve/ave se një faktor vendimtar që i vendos kandidatët/et me aftësi dhe kualifikime të barabarta në një pozitë të pabarabartë në punësim është pikërisht përkatësia e tyre politike dhe etnike.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual sipas publikut është i renditur në fund të listës. Tregues për distancimin e popullatës së përgjithëshme nga kjo kategori qytetarësh/esh, mund të shihet nga fakti se ky grup është më së paku i pranuar si fqinj/e apo mik/e. Megjithatë, ekziston një rritje e dukshme e numrit të qytetarëve/eve të cilët e njohin diskriminimin ndaj këtij grupi.

Përgjigjet në pyetjen nëse diskriminimi është më pak apo më shumë i përhapur krahasuar me pesë vite më parë, tregon se perceptohet si e shpeshtë. Megjithatë, ka një tendencë rritëse e numrit të qytetarëve/eve të cilët konsiderojnë se ky diskriminim është i rrallë. Të dhënat nga hulumtimi, tregojnë se sipas perceptimit të të anketuarëve/eve, rezultatet më të mira në luftën kundër diskriminimit janë arritur në llojet e diskriminimit në bazë: të moshës, personave me aftësi të kufizuara dhe gjinisë. Në afat të mesëm, perceptimi i diskriminimit është më i pafavorshëm në aspektin e përkatësisë politike. Pesë herë më i madh është numri i të anketuarëve/ave, që konsiderojnë se ky lloj i diskriminimit është më i shpeshtë.

Të dhënat tregojnë një reduktim të dukshëm⁵ në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë si të shpeshtë për nëntë vitet e fundit. Por, duhet të theksohet se kjo prirje rënëse vjen nga ata të anketuar/a të cilët as nuk janë diskriminuar dhe as nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Nga ana tjetër, diskriminimi i shumëfishtë perceptohet si i përhapur nga viktimat e diskriminimit. Gjysma e tyre në të tri sondazhet (2009, 2013 dhe 2018) kanë raportuar se ishin objekt i diskriminimit të shumëfishtë.

Në shkallën e tolerancës ndaj grupeve të ndryshme, të anketuarit/at tregojnë gatishmëri të madhe për të pranuar anëtarë të përkatësive politike "të tjera" dhe anëtarë të bashkësive etnike "të tjera" si fqinjë dhe si mbajtës të pozitës më të lartë politike të zgjedhur. Në zonën negative të "barometrit" të tolerancës, ndrojtja ndaj njerëzve me orientim të ndryshëm seksual është shprehur qartë, si në sferën publike ashtu edhe në atë private.

Të dhënat për përvojat personale të diskriminimit, tregojnë se më shumë të anketuar/a deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit sesa viktime të diskriminimit. Në të gjitha hulumtimet, përkatësia politike është e renditur e para në situata kur ata kanë përjetuar diskriminim dhe në situata, ku ata kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Baza e dytë, e renditur për përvojën personale të diskriminimit dhe dukshëm më pak e përhapur është diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike.

Në perceptimin e publikut dominojnë tri faktorë dominues të cilët rezultojnë në trajtimin e pabarabartë gjatë punësimit: përkatësia politike, mosha e kandidatëve dhe përkatësia e tyre etnike. Në anën tjetër, gatishmëria për të mbështetur masa afirmative, për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit, u jep përparësi grupeve sipas: moshës së kandidatëve/eve, personave me aftësi të kufizuara dhe përkatësisë etnike të tyre.

Vlerësimi publik i përpjekjeve për të luftuar diskriminimin me kalimin e kohës, tregon një tendencë në rënie në vlerësimin se janë duke u bërë përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin.

Shumica e të anketuarëve/ave, deklarojnë se nuk i njohin të drejtat e tyre, nëse ata do të ishin viktimë e diskriminimit. Por, një zbulim i rëndësishëm është se ka rritje të njohurit për të drejtat midis atyre që kanë qenë viktime të diskriminimit.

Të anketuarit/at, të cilët kanë deklaruar se do të kërkonin mbrojtje nëse do të ishin viktime të diskriminimit, më së shpeshti do të drejtoheshin në polici dhe në përmasa më të vogla do të drejtoheshin gjykatës, Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit, avokatëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Analiza e ndërveprimeve mes grupeve të ndryshme sociale, tregon se shumica dërrmuese e qytetarëve/eve i perceptojnë anëtarët e grupeve të ndryshme shoqërore, si pjesë të rrethit të tyre shoqëror në komunikimet e përditshme. Të dhënat e hulumtimit, tregojnë se shumica e të anketuarëve/ave kanë raportuar të kenë mik/e ose të njohur/a me përkatësi politike, etnike dhe fetare të ndryshme nga ajo personale. Tre nga pesë të anketuar/a u përgjigjën se kanë mik/e ose të njohur/a nga komuniteti etnik rom dhe persona me aftësi të kufizuara. Në të kundërt, vetëm një nga dhjetë të anketuar/a kanë raportuar se në rrethin e tyre shoqëror ka persona me orientim të ndryshëm seksual.

1. Vendosja e kontekstit

1.1 A keni mik/e apo të njohur/a të cilët janë anëtarë të një grupi/ grupeve të caktuara?


Hulumtimi tregon se ende ekziston një shumicë e madhe e të anketuarëve/ave, të cilët janë të gatshëm/e të marrin në konsideratë anëtarët/et e grupeve të ndryshme shoqërore si pjesë e rrethit të tyre shoqëror. Në vitin 2018, katër nga pesë të anketuar/a deklarojnë se kanë mik/e apo të njohur/a, të cilët janë të ndryshëm nga ata në aspektin e pikëpamjeve politike (82%), në përkatësi të ndryshme kombëtare (81%) dhe të përkatësisë fetare (78%). Përderisa tre nga pesë të anketuar/a janë përgjigjur se kanë mik/e apo të njohur/a, të cilët i përkasin bashkësisë etnike rome (59%) dhe persona me aftësi të kufizuar (60%). Vetëm një në dhjetë të anketuar/a, deklaroi se në rrethin e tyre më të ngushtë apo më të gjerë shoqëror, takon edhe persona me orientim të ndryshëm seksual (10%) (shiko Grafikon nr. 1).

Në nëntë vitet e fundit është zvogëluar numri i të anketuarëve/ave, që deklarojnë se kanë mik/e apo të njohur/a që i përkasin ndonjë partie politike me qëndrimet e së cilës nuk pajtohen (**2009** – 88%, **2013** - 89%, **2018** - 82%) dhe persona me aftësi të kufizuar (**2009** – 65%, **2013** - 63%, **2018** - 60%). Është vërejtur rritje e vogël te të anketuarit/at, të cilët deklarojnë se kanë mik/e dhe të njohur/a, që i përkasin një bashkësie kombëtare të ndryshme nga ato (**2009** – 78%, **2013** - 86%, **2018** - 81%).

6 [Ndryshimet e të dhënave që rezultojnë nga hulumtimi i vitit 2013 mund të jenë për shkak të metodologjisë së ndryshuar të përdorur për hulumtimin \(metoda e anketës së vitit 2013 është me telefon, dhe në vitin 2009 dhe 2018 janë ballë për ballë në shtëpinë e të anketuarit\)](#)

1

A keni miq apo të njohur të cilët janë...?



Të pasurit e miqve /të njohur/ave të cilët i përkasin një bashkësie tjetër etnike është më e shpeshtë te:

- ▶ meshkujt sesa te femrat;
- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 54, sesa ata në moshë mbi 55;
- ▶ ata me arsim më të lartë se të mesëm sesa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave urbane sesa rurale.

Edhe pse të pasurit e miqve/të njohur/ave që i përkasin një bashkësie tjetër etnike te femrat dhe banorët/et e rrethinave rurale shënon rritje, kjo dukuri ende është më e shpeshtë tek meshkujt dhe banorët/et e rrethinave urbane. Dallim i rëndësishëm i shënueshëm paraqitet te bashkësitë e ndryshme etnike dhe religjioze në vend. Përkatësisht te maqedonasit/et etnik/e dhe te ata të cilët i përkasin besimit religjioz krishterë, në numër shumë më të madh paraqiten të anketuar/a, të cilët deklarojnë se kanë miq/të njohur/a nga bashkësi religjioze tjetër sesa te shqiptarët/et etnik/e dhe te ata të besimit religjioz islam. Numri i të anketuarëve/ave, të cilët deklarojnë se kanë mik/e /të njohur/a nga bashkësi të ndryshme etnike zvogëlohet me moshën (shiko Tabelën nr. 1)

1

Të pasurit e miqve /të njohur/ave të cilët i përkasin një bashkësie tjetër etnike

Gjinia:	Mashkull			Femër		
2009	85%			71%		
2018	86%			77%		
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	78%	81%	78%	81%	78%	74%
2018	82%	83%	83%	83%	79%	77%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	70%		82%		86%	
2018	70%		84%		86%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	79%			69%		
2018	84%			69%		
Përkatësia religjioze:	Krishter/e			Mysliman/e		
2009	80%			75%		
2018	84%			75%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	84%			71%		
2018	84%			78%		

Në përgjithësi, numri i të anketuarëve/ave të cilët kanë deklaruar se kanë miq/të njohur/a romë, praktikisht nuk ka ndryshuar, kur krahasohen 2009 [60% dhe 2018 [59%]. Mirëpo, analiza krahasuese tregon se ka ardhur deri në ndryshime të caktuara në profilin socio-demografik të të anketuarëve/ave, të cilët kanë mik/e romë (shiko Tabelën nr. 2).

Të pasurit miq/të njohur/a romë është më i zakonshëm te:

- ▶ meshkujt sesa te femrat;
- ▶ të anketuarit/at më të moshuar/a sesa në moshë më të re;
- ▶ ata me arsim më të lartë se të mesëm sesa ato me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ banorët e rrethinave urbane sesa rurale.

Është vërejtur rënie te të anketuarit meshkuj, të cilët deklarojnë se kanë mik/e/të njohur/a romë/e dhe një rritje e vogël te të anketuarat femra. Për herë të parë zvogëlohet sipas gjinisë dallimi i konsiderueshëm prej 12 pikë përqindjeje⁷ (në vitin 2009) në statistikisht të parëndësishme 2 p.p. (2018). Trend i rënies është i pranishëm te të gjitha grupmoshat, përveç te popullata në moshë mbi 65 vjet, te të cilët ka një rritje të vogël. Njëkohësisht, me rritjen e moshës dhe me arsimin e kryer te të anketuarit/at, rritet edhe përqindja e atyre të cilët deklarojnë se kanë mik/e/të njohur/a/a romë/e. Edhe pse, ky pohim është më i zakonshëm tek ata me arsim të mesëm dhe të lartë, megjithatë tek ata vërehet se ka një tendencë të rënies. Dallimi më i dukshëm shihet sipas përkatësisë etnike dhe religjioze të të anketuarëve/ave, i cili ka tendencë në rritje. Dallimi mes maqedonasve etnik dhe Shqiptarëve etnik nga 34 p.p. të larta nga viti 2009, është rritur në - 40 p.p. në vitin 2018. Te maqedonasit/et etnik/e dhe të përkatësisë së besimit religjioz krishterë është shumë më e zakonshme të kenë mik/e/të njohur/a romë/e, sesa te shqiptarët/et etnik/e dhe të përkatësisë së besimit religjioz islam, pavarësisht se shumica e romëve/eve deklarohen si myslimanë. Një dallim i dukshëm, prej 20 p.p. ekziston edhe sipas vendbanimit të të anketuarëve/ave, në një numër shumë më të madh frekuenca e pasjes së miqve /të njohur/a romë është e pranishme në rajonet urbane.

⁷ Pika e Përqindjes (pp) është një njësi matëse për diferencën aritmetike mes dy përqindje.

Tabela

2

Të pasurit miq/të njohur/a romë

Gjinia:	Mashkull		Femër	
2009	66%		54%	
2018	60%		58%	

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	55%	61%	57%	65%	66%	58%
2018	47%	52%	65%	62%	65%	63%

Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	52%	64%	65%
2018	52%	62%	60%

Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	67%	33%
2018	69%	29%

Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e
2009	67%	43%
2018	69%	40%

Vendbanimi:	Urban	Rural
2009	68%	48%
2018	68%	47%

Të pasurit mik/të njohur/a me orientim të ndryshëm seksual është më i zakonshëm te:

- ▶ të anketuarit/at në moshë më të re sesa më të moshuarit;
- ▶ ata me arsim të lartë të përfunduar, sesa ata me arsim fillor dhe të mesëm;
- ▶ maqedonas/e etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et;dhe
- ▶ banorët e rrethinave urbane sesa rurale.

Frekuenca e pasjes mik/e/të njohur/a me orientim të ndryshëm seksual, zvogëlohet me moshën e të anketuarëve/ave dhe më së paku është e mundshme te të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet. Tendencë pozitive është vërejtur te grupmoshat mes 25 dhe 64 vjet. Dukshëm më e lartë është mundësia e pasjes mik/e/të njohur/a me orientim të ndryshëm seksual te të anketuarit/at me arsim të lartë të përfunduar. Frekuenca është më e lartë te maqedonasit/et etnik/e, të krishterët/et dhe te banorët/et e rrethinave urbane, te të cilët vërehet një tendencë e vogël e rritjes gjatë viteve (shiko Tabelën nr. 3).

Tabela

3

Të pasurit mik/të njohur/a me orientim të ndryshëm seksual

Gjinia:	Mashkull				Femër	
2009	7%				9%	
2018	10%				11%	
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	14%	10%	6%	6%	4%	3%
2018	12%	15%	9%	12%	11%	3%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	5%		9%		13%	
2018	4%		11%		15%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	9%			5%		
2018	13%			5%		
Përkatësia religjioze:	Krishter/e			Mysliman/e		
2009	8%			5%		
2018	12%			6%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	10%			5%		
2018	15%			5%		

Të pasurit mik/të njohur/a me aftësi të kufizuar është më i zakonshëm te:

- ▶ meshkujt sesa te femrat;
- ▶ të anketuarit/at në moshë prej 45 deri 64, sesa ata në moshë prej 15 deri 24;
- ▶ ata me arsim të lartë të përfunduar sesa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et;dhe
- ▶ banorët e rrethinave urbane sesa rurale.

Të pasurit mik/e/të njohur/a me aftësi të kufizuar, ende është më i zakonshëm te popullata mashkullore sesa femërore edhe pse te të dy grupet, vërehet një rënie në hulumtimin e fundit. Tendencë e rënies paraqitet pothuajse te të gjitha grupmoshat, dhe rënie më të madhe prej 10 p.p. ka tek ata prej moshës 25-34 vjet. Në vitin 2018 te të anketuarit/at në moshë mes 45 dhe 64 vjet është më e zakonshme të kenë mik/e/të njohur/a me aftësi të kufizuara dhe më së paku e zakonshme është te popullata më e re, në moshë mes 15 dhe 24 vjet. Edhe pse të pasurit e një mik/e/të njohurit/a me aftësi të kufizuara është më i zakonshëm te ata me arsim të mesëm apo të lartë, megjithatë, tek ata, vërehet një tendencë e dukshme. Ende diferenca mes dy bashkësive më të mëdha etnike dhe religjioze në vend është e madhe, te maqedonasit/et etnik/e dhe të krishterë/e, në një numër dukshëm më të madh është e zakonshme të pasurit e një mik/e/të njohur/a me aftësi të kufizuar sesa te shqiptarët/et etnik/e dhe myslimanët/et. Dallimi i vogël mes banorëve në rrethina të ndryshme prej nëntë vitesh rritet edhe pse banorët e qytetit, më shpesh deklarojnë se kanë mik/e/të njohur/a me aftësi të kufizuar për dallim nga banorët rajoneve rurale. Megjithatë, te të dy grupet vërehet tendencë në rënie (shiko Tabelën nr. 4).

4

Të pasurit mik/të njohur/a me aftësi të kufizuar

Gjinia:	Mashkull		Femër			
2009	68%		61%			
2018	63%		57%			
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	58%	68%	64%	72%	65%	63%
2018	53%	58%	59%	66%	66%	58%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	58%		68%		71%	
2018	53%		61%		64%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	68%		58%			
2018	63%		51%			
Përkatësia religjioze:	Krishter/e		Mysliman/e			
2009	68%		56%			
2018	64%		52%			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	66%		63%			
2018	62%		57%			

Të pasurit mik/të njohur/a të një religjioni/bindjeje tjetër është më i zakonshëm te:

- ▶ meshkujt sesa te femrat;
- ▶ të anketuarit/at në moshë prej 35 deri 44 vjet,sesa ata në moshë prej 15 deri 24 vjet;
- ▶ ata me arsim më të lartë të përfunduar se sa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et dhe myslimanët/et;
- ▶ banorët e rrethinave urbane sesa rurale.

Shpeshtësia e të pasurit mik/e/të njohur/a të një religjioni/bindjeje tjetër rritet me nivelin e arsimit të përfunduar. Dallimi te bashkësitë etnike është rritur nga 6 p.p. (2009) në 16 p.p.(2018). Te maqedonasit/et etnik/e është më e zakonshme të pasurit mik/e/të njohur/a, i cili i takon një religjioni tjetër dhe ka tendencë në rritje. Përderisa te shqiptarët/et etnik/e, kjo dukuri është më pak e mundshme të kenë mik/e dhe të njohur/a me religjion të ndryshëm me tendencë rënëse gjatë viteve.Në hulumtimin e fundit ekziston rritje e dukshme e dallimit mes dy bashkësive fetare më të mëdha. Në vitin 2009, pothuajse nuk ka pasur aspak dallim edhe pas nëntë vitesh ajo është rritur në 10 p.p. Te të anketuarit/at me besim krishterë është më i zakonshëm të pasurit e mikut/mikes/të njohurit/at/të njohur/ës, i/e cili/cila i përket

një religjioni apo bindjeje tjetër të ndryshme nga ata, përdherisa të myslimanët/et, kjo dukuri është jo vetëm dukshëm më pak e zakonshme, por ka edhe tendencë në rënie. Në numër shumë më të madh, frekuenca e pasjes mik/e/të njohur/a të një religjioni tjetër është i pranishëm në rrethinat urbane dhe ka tendencë në rritje (shiko Tabelën nr. 5).

Tabela

5

Të pasurit mik/të njohur/a të një religjioni/bindjeje tjetër

Gjinia:	Mashkull		Femër			
2009	81%		70%			
2018	81%		74%			
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	75%	76%	77%	79%	76%	71%
2018	74%	79%	81%	79%	77%	76%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	66%		80%		86%	
2018	66%		79%		84%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	76%		70%			
2018	81%		65%			
Përkatësia religjioze:	Krishter/e		Mysliman/e			
2009	76%		74%			
2018	81%		71%			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	79%		72%			
2018	83%		71%			

Të pasurit e miqve/të njohur/ave që i përkasin ndonjë partie politike me qëndrimet e të cilave nuk pajtohen, është më e shpeshtë te:

- ▶ meshkujt sesa të femrat;
- ▶ të anketuarit/at në moshë mbi 35 vjet, sesa ata në moshë prej 15 deri 24 vjet;
- ▶ ata me arsim më të lartë të përfunduar se të mesëm sesa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et
- ▶ banorët e rrethinave urbane sesa rurale.

Dallimi midis gjinive rreth frekuencës e të pasurit mik/e dhe /të njohur/a, që i përket ndonjë partie politike me qëndrimet e së cilës të anketuarit/at nuk pajtohen, është zvogëluar nga 6 p.p. (2009) në 4 p.p. Edhe pse për meshkujt është diçka më e zakonshme të kenë këtë lloj të të njohurëve/ave sesa për femrat, tek të dy grupet vërehet një rritje e dukshme në hulumtimin e fundit. Hulumtimi i fundit tregon një rënie të madhe të popullata më e re mes 15 dhe 24 vjet (15 p.p.) dhe mes 25 dhe 34 (10 p.p.). Me moshën e të anketuarëve/ave rritet edhe frekuenca e të pasurit miq/të njohur/a me qëndrime politike të ndryshme. Tendencë negative është vërejtur edhe të të gjitha nivelet e arsimit të përfunduar të të anketuarëve/ave, fillor (9 p.p.), të mesëm (6p.p.) dhe më të lartë (10 p.p.). Megjithatë kjo dukuri është më e pranishme me rritjen e nivelit të arsimit të përfunduar të të anketuarëve/ave. Më i rëndësishëm është dallimi të bashkësitë e ndryshme etnike, i cili është rritur nga 5 p.p. (2009) në 23 p.p. (2018). Kjo është kryesisht për shkak të rënies së theksuar të shqiptarëve etnik prej 20 p.p në hulumtimin e fundit në vitin 2018. Hulumtimi tregoi se në rrethin shoqëror të maqedonasëve/eve etnik/e është shumë më e zakonshme që të numërojnë kundërshtarë politik. Të pasurit mik/e dhe të njohur/a të cilët i përkasin ndonjë partie politike me qëndrimet e të cilës nuk pajtohen është më e pranishme në mesin e të anketuarëve/ave në rrethinat urbane sesa në rrethinat rurale, me rënie të madhe prej 11 p.p. [shiko Tabelën nr.6].

Tabela

6

Të pasurit e miqve/të njohur/ave, që i përkasin ndonjë partie politike me qëndrimet e të cilave nuk pajtohen

Gjinia:	Mashkull		Femër			
2009	91%		85%			
2018	84%		80%			
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	85%	91%	87%	90%	87%	86%
2018	70%	81%	86%	86%	84%	86%
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	81%	90%		97%		
2018	72%	84%		87%		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	90%		85%			
2018	88%		65%			
Përkatësia religjioze:	Krishter/e		Mysliman/e			
2009	90%		83%			
2018	88%		70%			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	88%		87%			
2018	86%		76%			


1.2 Në vendbanimin tuaj, a e konsideroni veten t'i përkisni një pakice të caktuar?

Përqindja e të anketuarëve/ave, të cilët veten e perceptojnë si anëtarë/e të pakicës në vendin ku jetojnë në nëntë vitet e fundit është zvogëluar për 7 p.p., prej 42% në (2009) në 35% (2018). Në tërë periudhën, më të shumtë në numër janë ata që ndihen si pakicë etnike (2009 - 16%, 2018 - 13%), pakicë në aspektin e përkatësisë politike (2009 - 12%, 2018 - 9%) dhe pakicë në bazë të përkatësisë religjioze (2009 - 8%, 2018 - 9%). Njëkohësisht, numër shumë i vogël i të anketuarëve/ave deklarohen se i përkasin pakicës në bazë të aftësive të kufizuara (2009 - 3%, 2018 - 3%) dhe të orientimit seksual - 1%, 2018 - 1%) (shiko Grafikon nr. 2).

Grafiku nr.

2

A i përkisni një pakice të caktuar në vendbanimin tuaj...?



Edhe pse numri i shqiptarëve/eve dhe i maqedonasëve/eve etnik/e, të cilët kanë deklaruar se e konsiderojnë veten se i takojnë **pakicës etnike** është zvogëluar në nëntë vitet e fundit, megjithatë dallimi mes tyre mbetet i njëjtë, ende shqiptarët/et etnik/e në numër më të madh se maqedonasit/et etnik/e, e perceptojnë veten si pakicë etnike në vendin ku jetojnë. Në aspektin e **përkatësisë politike**, numri i shqiptarëve/eve etnik/e, që deklarohen si anëtarë/e të një pakice mbi këtë bazë është ulur për 11 p.p., gjë që në vitin 2018 është i ngjashëm me maqedonasit/et etnik/e. Numri i atyre që ndihen si anëtarë/e të një pakice, sipas **përkatësisë religjioze** të deklaruar të të anketuarëve/ave, nuk është i ndryshuar. Numri i myslimanëve/eve ende është më i madh se numri i të anketuarëve/ave, të cilët janë deklaruar se i përkasin besimit krishterë (shiko Tabelën nr. 7).

A mendoni se në vendbanimin tuaj i përkisni një...

Pakicë etnike:	Përkatësia etnike:	
	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	8%	21%
2018	5%	17%
Pakicë në aspektin e përkatësisë politike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	9%	20%
2018	9%	9%
Pakicë në aspektin e përkatësisë religjioze:	Përkatësia religjioze:	
	Krishter/e	Mysliman/e
2009	4%	16%
2018	6%	16%

2.

Perceptimi i diskriminimit

2.1 Niveli i perceptimit të diskriminimit

R e z u l t a t e t nga tri hulumtimet e zhvilluara më 2009, 2013 dhe më 2018, tregojnë se perceptimi i ekzistencës së diskriminimit është më i përhapur sesa mungesa e perceptimit (shiko Grafikonin numër 3). Gjatë nëntë viteve të fundit, hulumtimet kanë regjistruar një reduktim të përgjithshëm të numrit të qytetarëve/qytetareve, që konsiderojnë se nuk ka diskriminim në vend, treguesit mesatarë se diskriminimi nuk ekziston për të gjitha llojet e diskriminimit (2009 - 14% : 2013 - 13% : 2018 - 9%). Rënia më e madhe e perceptimit se diskriminimi nuk ekziston është për diskriminimin në bazë të orientimit seksual prej 16% në (2009) në 7% në vitin (2018). Përndryshe, vargu i perceptimeve që diskriminimi nuk ekziston ndryshojnë në diapazon prej 4% për përkatësinë politike në vitin 2018 deri në 18% për besimin dhe fenë në vitin 2009.

Përgjigjet "nuk e di" në lidhje me të gjitha format e diskriminimit janë në nivelin e vlerave margjinale, që ndryshojnë nga 2% për përkatësinë politike deri në 5% për religjionin dhe bindjet dhe për aftësinë e kufizuar. Përrjashtim i vetëm janë është përgjigjet për diskriminimin e bazuar në orientimin seksual, për të cilin në të tri hulumtimet përfshin 20%.

Në mënyrë që të arrihet një pasqyrë e saktë në ndryshimet e perceptimeve të të anketuarëve/ave, diskriminimi mbi të gjitha bazat renditet nga më e përhapura deri te më së paku e përhapur. A është diskriminimi i perceptuar si i shpeshtë përcaktohet duke përdorur përgjigjet e grumbulluara nga „shumë e shpeshtë“ dhe „mjaft e shpeshtë“.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike konsiderohet të jetë më i shpeshtë dhe më i përhapur, në të tri studimet. Për atë kanë thënë se është e shpeshtë në 2009 dhe 2013 - 78% dhe në 2018 - 77%.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike mbetet e dyta e ranguar në të tri hulumtimet, megjithëse ekziston një tendencë e zvogëlimit të numrit të qytetarëve që e perceptojnë atë si të shpeshtë, (2009 - 55% : 2013 - 51% : 2018 - 50%).

Në vitin 2009 **diskriminimi në bazë të orientimit seksual**, ishte e pesta me radhë, me 40% të përgjigjeve se është e shpeshtë. Numrii këtyre përgjigjeve është rritur dukshëm në vitin 2013 në 46%, kur kjo bazë renditet e treta. Në vitin 2018, ndonëse ka pasur një rënie të lehtë në 44%, ajo mbetet e ranguar në vendin e tretë.

Diskriminimi në bazë të aftësive të kufizuara, mbetet e katërta e renditur në të tri hulumtimet, megjithëse ka një reduktim të vazhdueshëm të përgjigjeve se është e shpeshtë, nga 45% në vitin 2009 në 42% në 2013 dhe 41% në vitin 2018.

Diskriminimi në bazë të moshës, ka rënie të konsiderueshme në përgjigjet se është e shpeshtë. Prej 49%, në vitin 2009, kur është renditur e treta, në vitin 2013 ka rënë në 40% dhe është renditur e gjashta. Në hulumtimin e fundit rangohet e pesta me 41%.


Diskriminimi në bazë të fesë dhe të besimit, tregon ndryshime të caktuara në përgjigjet se është e shpeshtë, nga 37% në vitin 2009, kur ishte e shtata e ranguar, në 41% në vitin 2013 kur ishte e pesta e ranguar. Në vitin 2018 pëson një rënie të lehtë në 39% dhe rangohet e gjashta.

Diskriminimi në bazë të gjinisë, në vitin 2009 40% e të anketuarëve/ave konsideronin që është e shpeshtë dhe atëherë ka qenë e gjashta e ranguar, pastaj në dy hulumtimet e ardhshme (2013 dhe 2018), frekuenca e përgjigjeve të tilla ka pësuar një rënie në 37% dhe për këtë arsye rangohet e fundit, si e shtata e ranguar.

Grafiku nr.

3

Sa e zakonshme është secila nga këto forma të diskriminimit në vendin tonë?



Duke gërshetuar rezultatet sipas karakteristikave socio-demografike, mund të vërehet se të anketuarit, të cilët e konsiderojnë diskriminimin në bazë të përkatësisë politike si dukuri e shpeshtë janë:

- ▶ meshkuj (2009 - 80%; 2018 - 79%) sesa femrat (2009 dhe 2018 - 76%); dhe;
- ▶ me arsim më të lartë (2009 - 79%; 2018 - 77%) dhe arsim të mesëm (2009 - 81%; 2018 - 82%) sesa me arsim fillor (2009 - 73%; 2018 - 67%).

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike perceptohet si i shpeshtë, më tepër nga:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 24 vjet (2009 - 64%; 2013 - 58%; 2018 - 60%) sesa të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet (2009 - 48%; 2013 - 45%; 2018 - 38%);
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e (2009 - 75%; 2013 - 80%; 2018 - 63%) sesa maqedonasit/et etnik/e (2009 - 48%; 2013 - 43%; 2018 - 45%); dhe
- ▶ Banorët/banoret e rajonit të Pollogut dhe Verilindor (ndryshon prej 59% deri 70%) sesa ata të rajonit Lindor (34%).

Perceptimi i diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike si i shpeshtë, zvogëlohet me moshën e të anketuarëve/ave.

Diskriminimin në bazë të orientimit seksual perceptohet si i shpeshtë më tepër nga:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 24 vjet (2009 dhe 2018 - 49%) sesa të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet (2009 - 29%; 2018 - 33%);
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë (2009 - 47%; 2018 - 50%), sesa ata me arsim fillor (2009 - 30%; 2018 - 38%); dhe
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e (2009 - 45%; 2018 - 46%) sesa shqiptarët/et etnik/e (2009 - 28%; 2018 - 43%).

Në vitin 2009, perceptimi për diskriminimin në bazë të orientimit seksual si i shpeshtë është më i lartë tel maqedonasit/et etnik/e (45%), për dallim nga shqiptarët/et etnik/e (28%). Në vitin 2018 i perceptimi i tillë te maqedonasit/et etnik/e ka mbetur pothuajse në nivelin e njëjtë (46%), ndërsa te shqiptarët/et etnik/e është rritur konsiderueshëm në (43%).

Diskriminimi në bazë të përkatësisë gjinore është perceptuar si i shpeshtë, më tepër nga:

- ▶ femrat (2009 - 43%; 2018 - 40%) sesa meshkujt (2009 - 37%; 2018 - 34%);
- ▶ shqiptarët/et etnik/e (2009 - 49%, 2018 - 40%) sesa maqedonasit/et etnik/e (2009 - 38%; 2018 - 36%).

Perceptimi i diskriminimit në bazë të aftësive të kufizuara si i shpeshtë vazhdimisht po ulet. Edhe në 2009 edhe në 2018 të anketuarit/at ndërmjet: femrave, grup moshës prej 25 deri 34 vjet, maqedonasit/et etnik/e dhe të anketuarit/at në rrethinat urbane në një numër mbi mesataren përgjigjen se ky diskriminim është i shpeshtë.

Diskriminimi në bazë të moshës është perceptuar si i shpeshtë më tepër nga:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë mbi 55 vjet (**2009** - 53%; **2018** - 46%), sesa të rinjtë në moshë prej 15 deri 24 vjet (**2009** - 44%; **2018** - 33%); ;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim të mesëm (2009 - 51%; 2018 - 44%) sesa me arsim fillor (2009 - 44%; 2018 - 41%);
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e (**2009** - 51%; **2018** - 46%) sesa shqiptarët/et etnik/e (**2009** - 43%; **2018** - 31%).

Perceptimi i diskriminimit në bazë të moshës më shpesh paraqitet tek më të moshuarit, të anketuarit/at me arsim të mesëm dhe maqedonasit/et etnik/e. Relativisht më rrallë paraqitet tek më të rinjtë, të anketuarit/at me arsim fillor dhe Shqiptarët/et etnik/e.

Diskriminimi në bazë të religjionit apo bindjes është i perceptuar si i shpeshtë, më tepër tek:

- ▶ më të rinjtë në moshë prej 15-24 (47% në dy hulumtimet) sesa te më të moshuarit në moshë mbi 65 vjet (2009 - 31%, 2018 - 28%);
- ▶ shqiptarët/et etnik/e (2009 - 50%; 2018 - 49%) sesa maqedonasit/et etnik/e (2009 - 32%; 2018 - 35%); dhe
- ▶ Myslimanët/et (2009 - 47%; 2018 - 46%) sesa të krishterët/et(2009 - 32%; 2018 - 35%).

Perceptimi se diskriminimi në bazë të religjionit dhe bindjes është i shpeshtëvërehet qartë te numër më i madh i të rinjëve në moshë prej 15 - 24 vjet 47% edhe në 2009 edhe në 2018, në krahasim me më të moshuarit mbi 65 vjet, me 31 % dhe 28% përkatësisht. Këtë lloj diskriminimi në një numër të konsiderueshëm më të madh e perceptojnë shqiptarët/et etnik/e, sesa maqedonasit/et etnik/e. Numër më i madh i përkatësuesëve/eve të besimit Islam e perceptojnë këtë diskriminim si të shpeshtë, dhe në numër më të vogël ky diskriminim është i pranishëm tek përkatësuesit/et e besimit krishter. Në hulumtimin e fundit vërehet një tendencë për reduktim të hendekut të perceptimit mes të anketuarëve/ave të të dy religjioneve.

2.2 Niveli i perceptimit të diskriminimit në afat të mesëm


Analiza e përgjigjeve në pyetjen se sa të shpeshta janë disa forma të diskriminimit në krahasim me pesë vite më parë, mundëson të vlerësohet perceptimi i të anketuarëve/ave për një periudhë më të gjatë kohore. Këto perceptime të diskriminimit janë indikator përmes të cilit mund të vlerësohen efektet e masave të ndërmarrura në luftën kundër diskriminimit. Përgjigjet se disa forma të diskriminimit janë më të shpeshta është një tregues i dështimit në luftën kundër diskriminimit, ndërsa përgjigjet se disa lloje të diskriminimit janë më të rralla tregojnë efektet pozitive të përpjekjeve për të reduktuar diskriminimin.

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se në aspektin e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, në vitin 2009 60% e të anketuarëve/ave konsiderojnë se është më e shpeshtë në krahasim me pesë vitet e mëparshme, 12% konsiderojnë se është më e rrallë dhe 24% konsiderojnë se ka mbetur e njejtë. Në vitin 2018 57% kanë vlerësuar se është më e shpeshtë, 11% se është më e rrallë dhe 30% se ka mbetur e njejtë. Përgjigjet se diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është më i shpeshtë janë më të shumta në numër kur krahasohen me llojet e tjera të diskriminimit, dhe për këtë arsye është e renditur e para, në të tri hulumtimet (shiko Grafiku numër 4).

Grafiku nr.

4

Nëse e krahasoni situatën e tanishme me atë prej para pesë vitesh, a do kishit thënë se format e diskriminimit që vijnë janë më të shpeshta apo më të rralla në vendin tonë?



6 Koeficienti K fitohen kur vlera e përgjigjeve më e shpeshtë pjesëtohet me vlerën më të rrallë. Çdo vlerë e K mbi 1 tregon sa është proporcionalisht më e madhe pjesëmarrja e vlerës më të shpeshtë në krahasim me vlerën më të rrallë. Koeficienti K më i madh se 1 tregon se nuk janë arritur rezultate të dukshme dhe/ apo stereotipat tradicionale negative paraqesin barrierë në ndryshimet. Koeficientet nën 1 tregojnë rezultat relativisht pozitiv në luftën kundër diskriminimit në një fushë konkrete, e cila është objekt i hulumtimit.


7 Hulumtimi i vitit 2013 nuk përfshiu kategorinë "as më shumë as më pak (njëjtë)", për këtë shkak krahasimet me rezultatet e vitit 2009 dhe 2018 janë marrë vetëm si një tregues i identifikimit të përmirësimeve të mundshme në strukturën e qëndrimeve në popullatë.

Për të fituar një imazh për perceptimin e publikut mbi situatën me diskriminimin a është përkeqësuar ose përmirësuar, ne kemi llogaritur koeficientin K⁶, që tregon se cili është proporcioni i përgjigjeve më e shpeshtë në krahasim me përgjigjet më e rrallë.

Grafiku nr.

5

Koeficienti K trend në pyetjenQ2 -Nese e krahasoni situaten e tanishme me ate prej para pese vitesh, a do kishit thene se format e diskriminimit qe vijojne jane me te shpeshta apo me te rralla ne Vendin tone?



Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike e para e ranguar për vitin 2009 me K= 4.89 (më e shpeshtë 59.6%; më e rrallë 12%), çka do të thotë se në këtë hulumtim pjesëmarrja e notës „më e shpeshtë” është 4.9 herë më tepër prezentë në krahasim me notën “më e rrallë”. Në vitin 2013 K=2.69⁶(më e shpeshtë 70%; më e rrallë 26%),, ndërsa për vitin 2018 K=5.01(më e shpeshtë 56.6%; më e rrallë 11.3%).

Gërshetimi me karakteristikat socio-demografike të të anketuarëve/ave tregon se:

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike në krahasim me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë më tepër nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - Në të dy hulumtimet të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 34 vjet, sesa ata në moshë mbi 55 vjet;
- ▶ Sipas arsimit
 - në vitin **2009**, nuk ka dallim të shënueshëm, mes të anketuarëve/ave me a shkallë të ndryshme të arsimit më të lartë (59%); arsim të mesëm (61%), arsim fillor (58%);
 - në vitin **2018** - më të lartë (60%) dhe arsim të mesëm (58%), sesa arsim fillor (50%).

Të anketuarit/at në moshë më të re, gjatë tërë periudhës së hulumtimeve nuk janë të kënaqur me nivelin e progresit në luftën kundër diskriminimit të bazuar në përkatësinë politike. Niveli i arsimit është gjithashtu i rëndësishëm në analizimin e përgjigjeve. Në vitin 2009, dallimi në perceptimin se është më e shpeshtë është i parëndësishëm tek të anketuarit/at me arsim fillor në krahasim me ata me arsim më të lartë. Mirëpo në vitin 2018 imazhi është më me kontrast edhe ata me arsim të lartë e konsiderojnë atë më të përhapur për dallim nga ata me arsim fillor.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është i dyti i ranguar. Për vitin 2009 koeficienti $K=1.39$ (më i shpeshtë 36.8%; më i rrallë 26.4%), për vitin 2013 $K=1.40$ (më i shpeshtë 56%; më i rrallë 40%), dhe në vitin 2018 $K=1.31$ (më i shpeshtë 34.4%; më i rrallë 26.3%). Të dhënat tregojnë se ka ardhur deri te një ndryshim i vogël në drejtimin e përmirësimit të perceptimit të kësaj forme të diskriminimit.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike në krahasim me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë më tepër nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - Në vitin **2009** nga ana e të anketuarëve/ave në moshë prej 15 deri 44 vjet (ndryshon prej 38% deri 40%) sesa tek ata në moshë mbi 55 vjet (ndryshon prej 29% deri 33%);
 - Në vitin **2018** nga ana e të anketuarëve/ave në moshë prej 15 deri 34 (ndryshon prej 39% deri 42%) sesa te ata në moshë mbi 55 vjet (ndryshon prej 26% deri 27%).
- ▶ Sipas përkatësisë etnike:
 - Në të dy hulumtimet – shqiptarët/et (**2009**: 59%; **2018**: 50% sesa te maqedonasit/et (**2009** - 30%; **2018** - 30%).
- ▶ Sipas vendbanimit:
 - Në dy hulumtimet banorët e rrethinave rurale (**2009** - 40%; **2018** - 36%) sesa të banorët e rrethinave urbane (**2009** - 35%; **2018** - 33%).

Në vitin 2009 të të anketuarit/at në moshë prej 15 deri më 44 vjet, është më e madhe gatishmëria të vlerësojnë se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është më i shpeshtë krahasuar me 5 vitet e mëparshme, krahasuar me të anketuarit/at në moshë mbi 55 vjet. Në aspektin e përkatësisë etnike edhe pse shqiptarët/et në numër më të madh vlerësojnë se diskriminimi është më i shpeshtë në krahasim me maqedonasit/et, në të dy hulumtimet ka reduktim të perceptimit vetëm të Shqiptarët/et etnik/e. Në aspektin e vendbanimit në vitin 2009 edhe në vitin 2018, më frekvente është përgjigjja se diskriminimi është më i shpeshtë në rrethinat rurale krahasuar me rrethinat urbane, sidoqoftë hulumtimi i vitit 2018 tregon reduktim në vlerësim në të dy segmentet.

Diskriminimi në bazë të religjionit dhe të bindjes, në vitin 2009 është ranguar si i gjashtë ($K=0.92$). Atëherë më të numërta kanë qenë përgjigjet se diskriminimi është më i rrallë (28.5%), krahasuar me përgjigjet më i shpeshtë (26%). Në dy hulumtimet vijuese koeficienti K është në rritje. Në vitin **2013** $K=1.02$ (më i shpeshtë 48%; më i rrallë 47%), ndërsa në vitin **2018** $K=1.16$ (më i shpeshtë 29%; rrallë 25.1%). Të dhënat tregojnë se në vitin 2018 ka pësuar një ndryshim të përjetimeve të diskriminimit në publik, dhe për herë të parë perceptimet se është më i shpeshtë janë më të numërta sesa se është më i rrallë

Diskriminimi në bazë të religjionit dhe të bindjes krahasuar me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - Të rinjtë në moshë prej 15 deri 24 vjet (**2009** – 32%; **2018** – 37%) sesa të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet (**2009** – 21%; **2018** – 22%).
- ▶ Sipas arsimit:
 - Të anketuarit/at me arsim të mesëm (**2009** – 28%; **2018** – 30%) dhe arsim më të lartë (**2009** – 28%; **2018** – 31%) sesa me arsim fillor (**2009** – 22%; **2018** – 25%).
- ▶ Sipas përkatësisë etnike:
 - Në të dy hulumtimet - shqiptarët/et etnik/e (38%) sesa maqedonasit/et etnik/e (**2009** – 22%; **2018** – 26%).
- ▶ Sipas përkatësisë religjioze:
 - në të dy hulumtimet - nga ana e myslimanëve/eve (35%) sesa tekrishterët/et (**2009** – 22%; **2018** – 26%).
- ▶ Sipas vendbanimit:
 - në vitin **2009**, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, urban (27%) ose rural (25%);
 - në vitin **2018** më tepër nga ana e banorëve/eve të rrethinave rurale (31%) sesa urbane (28%).

Sipas përkatësisë religjioze, myslimanët/et në të dy hulumtimet (edhe në 2009 edhe në 2018), kanë vlerësuar se diskriminimi është më i shpeshtë sesa të krishterët/et. Gjithashtu edhe moshë, niveli e arsimit dhe përkatësia etnike e të anketuarëve/ave janë treguar si faktorë të cilët kanë ndikim të konsiderueshëm mbi perceptimin në plan afatmesëm për këtë lloj diskriminimi.

Diskriminimi në bazë të moshës në vitin 2009 është ranguar i treti, me koeficientin $K=1.48$ (më i shpeshtë 33%, më i rrallë 22.3%). Në vitin **2013**, koeficienti është zvogëluar $K=1.04$ (më i shpeshtë 48%; më i rrallë 46%). Në vitin **2018** vazhdon të zvogëlohet dhe bie nën numrin një $K=0.90$ (më i shpeshtë 25.5%; më i rrallë 28.3%). Kjo tregon një perceptim të reduktimit të diskriminimit në bazë të moshës dhe është një tregues i efekteve pozitive të masave të marra në luftën kundër këtij lloji të diskriminimit.

Diskriminimi në bazë të moshës krahasuar me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - në vitin **2009** nga të anketuarit/at në moshë prej 55 deri 64 vjet (43%) sesa më të rinjtë në moshë prej 15 deri 24 vjet (26%);
 - në vitin **2018**, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, te grup moshat prej 15 deri 24 vjet (28%), përkatësisht prej 55 deri 64 vjet (26%).

- ▶ Sipas arsimit:
 - Në vitin **2009** të anketuarit/at me arsim të lartë (38%) dhe arsim të mesëm (36%) sesa me arsim fillor (28%);
 - Në **2018** nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në aspektin e nivelit të arsimit: fillor dhe të mesëm (26%) dhe arsim i lartë (24%).

Rezultatet tregojnë se në vitin 2018, te kategori të ndryshme të të anketuarëve/ave ekziston tendencë e barazimit të perceptimeve se sa është i shpeshtë ky lloj diskriminimi, në krahasim me pesë vitet e mëparshme.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual, në vitin **2009** me $K=1.05$, tregon se ka ekzistuar balancë mes vlerësimeve se diskriminimi është më i shpeshtë (24.8%), krahasuar me vlerësimin se është më i rrallë (23.7%). Në vitin **2013** koeficienti është rritur $K=1.37$ (më i shpeshtë 48%; më i rrallë 35%) dhe është i pesti i ranguar, ndërsa në **2018** $K=1.18$ (më i shpeshtë 24.5%; më i rrallë 20.8%) është zvogëluar, mirëpo pavarësisht kësaj, ka mbetur si e pesta e ranguar.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual krahasuar me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - Në të dy hulumtimet, të anketuarit/at më të ri në moshë prej 15 deri 24 vjet (**2009** – 28%; **2018** – 31%) sesa ata në moshë mbi 65 vjet (**2009** – 21%; **2018** – 19%).
- ▶ Sipas arsimit:
 - Në të dy hulumtimet, të anketuarit/at me arsim më të lartë (**2009** – 28%; **2018** – 27%) sesa ata me arsim fillor (**2009** – 20%; **2018** – 22%).

Në vitin 2009 dhe 2018, të rinjtë dhe të anketuarit/at me arsim më të lartë kanë konsideruar se diskriminimi në këtë bazë është më i shpeshtë sesa në pesë vitet e mëparshme, krahasuar me të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet dhe të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar.

Diskriminimi në bazë të aftësive të kufizuara, në vitin **2009** me koeficienti $K=0.91$, kur 26.9% e të anketuarëve/ave kanë vlerësuar se është më i shpeshtë dhe 29.6% se është më i rrallë. Në vitin **2013**, ka pësuar rënie në $K=0.82$ (më i shpeshtë 42%; më i rrallë 51%) dhe në **2018**, koeficienti ka vazhduar të bie $K=0.75$ (më i shpeshtë 22.7%; më i rrallë 30.2%). Rezultati i përgjithshëm i të gjitha këtyre ndryshimeve reflektohet në trendin e zvogëlimit të koeficientit K , i cili është në rënie të vazhdueshme dhe është një tregues i përmirësimit të perceptimit të publikut për reduktimin e këtij lloji të diskriminimit.

Diskriminimi në bazë të aftësive të kufizuara krahasuar me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas moshës:
 - në vitin **2009** të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 44 vjet (26%) sesa te ata mbi 65 vjet (18%);
 - në vitin **2018**, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, në perceptimin sipas moshës së të anketuarëve/ave në moshë prej 15 deri 24 vjet, përkatësisht mbi 65 vjet (25%);
- ▶ Sipas përkatësisë etnike:
 - në dy hulumtimet, shqiptarët/et etnike (**2009** – 38%; **2018** – 29%) sesa maqedonasit (**2009** – 24%; **2018** – 22%).

Në hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018, personat në moshë më të re prej 15 deri 24 vjet, konsiderojnë se diskriminimi mbi këtë bazë është më i shpeshtë sesa në 5 vitet e kaluara, krahasuar me të anketuarit/at në moshë 65 vjet e më tepër. Për sa i takon përkatësisë etnike, megjithëse shqiptarët/et etnik/e konsiderojnë se diskriminimi është më i shpeshtë në krahasim me maqedonasit/et etnik/e në të dy hulumtimet, në vitin 2018, rënie e dukshme shihet vetëm në mesin e shqiptarëve/eve etnik/e.

Diskriminimi në bazë të gjinisë, nga i katërti i ranguar në vitin **2009** me koeficient $K=0.93$ (më i shpeshtë 27.3%; më i rrallë 29.3%), në vitin **2013** rangohet e gjashta me $K=0.94$ (më i shpeshtë 46%; më i rrallë 49%), dhe në hulumtimin e vitit **2018** rangohet e shtata me $K=0.67$ (më i shpeshtë 20.5%; më i rrallë 30.4%). Për këtë lloj të diskriminimit, në sytë e publikut në masë më të lartë është ndryshuar në drejtim pozitiv. Vlerësimi se është më i rrallë praktikisht nuk është ndryshuar (2009 - 29%; 2018 - 30%), ndërsa vlerësimi se është i shpeshtë nga 27% në vitin 2009 është zvogëluar në 21% në 2018.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë gjinore krahasuar me gjendjen para pesë vitesh është perceptuar si i shpeshtë nga grupet vijuese të të anketuarëve/ave:

- ▶ Sipas gjinisë:
 - në dy hulumtimet - nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm tek të anketuarit të gjinisë mashkullore (2009 - 27%; 2018 - 20%) dhe të anketuarat e gjinisë femërore (2009 - 28%; 2018 - 21%).

- ▶ Sipas arsimit:
 - Në të dy hulumtimet - të anketuarit/at me arsim të mesëm (2009 - 29%; 2018 - 22%) dhe arsim më të lartë (2009 - 30%; 2018 - 20%) sesa ata me arsim fillor (2009 - 24%; 2018 - 18%).

- ▶ Sipas përkatësisë etnike:
 - Në të dy hulumtimet - Shqiptarët/et etnik/e (2009 - 35%; 2018 - 24%) sesa maqedonasit/et etnik/e (2009 - 26%; 2018 - 19%).

Në vitin 2009 edhe femrat edhe meshkuj, në numër të barazuar edhe meshkujt edhe femrat, konsideruan se diskriminimi në bazë të përkatësisë gjinore është më i shpeshtë dhe në hulumtimin e fundit, vlerësimi i tillë është zvogëluar në mënyrë lineare te të dy gjinitë. Pavarësisht zvogëlimit të perceptimit se ky lloj i diskriminimit është më i shpeshtë, të dhënat tregojnë se shqiptarët/et etnik/e dhe të anketuarit/at me arsim të mesëm dhe më të lartë konsiderojnë se diskriminimi në bazë të gjinisë është më i shpeshtë se sa te maqedonasit/et etnik/e dhe të anketuarëve/ave me arsim fillor.

2.3 Pranimi i dallimeve

¹⁰ Në hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018, të anketuarit janë pyetur: Duke shfrytëzuar shkallë prej 1 deri me 10, a do mund të më tregoni si Ju personalisht do te ishit ndjerë në secilën nga situatat e dhëna. Ne shkallën „1“, do te thotë se ndjeheni „shumë pakëndshëm“, ndërsa „10“ do te thotë se ndjeheni „krejtësisht këndshëm“ në atë situatë. Shkalla e cila shfrytëzohet në hulumtimin e vitit 2013 është ndryshuar: Duke shfrytëzuar shkallën prej 1 deri në 9, a mund të më tregoni si Ju personalisht do te ishit ndjerë në secilën nga situatat e dhëna. Ne shkallën „1“ do te thotë se ndjeheni „shumë pakëndshëm“, ndërsa „10“ do te thotë se ndjeheni „krejtësisht këndshëm“ në atë situatë. Për këtë arsye, rezultatet e vitit 2013. merren vetëm si një indikator për identifikimin e ndryshimeve të mundshme të mëdha në strukturën e qëndrimeve në popullsi..

¹¹ Termi „tjetër / tjera“ në thonjëza përdoret për të treguar se këto janë grupe / bashkësi në të cilat të anketuarit/ anketuarat nuk i përkasin.


Hulumtimi tregon tendencë stabile, me gatishmëri të lartë të të anketuarëve/ave për pranimin e grupeve të ndryshme në rrethinën e tyre private të jetesës ¹⁰. Rezultatet tregojnë se gatishmëri më të madhe për pranim të një fqinji/e i/e cili/cila është përkatësues/e ose simpatizues/e ndonjë partie politike „tjetër“¹¹ dhe persona me aftësi të kufizuar.

Niveli i pranimin të anëtarëve të bashkësive fetare dhe etnike “të tjera” është rritur në hulumtimin e fundit (2018), gjë që i bën ata të pranueshëm në mënyrë të barabartë për të anketuarit/at, si dhe për dy grupet e mëparshme. Pranimi i një fqinji/e nga bashkësia etnike rome është mjaft e lartë, mirëpo prap se prap është më e ulët në krahasim me se ato në përgjithësi për pranimin e një fqinji/e nga një bashkësi “tjetër” etnike. Gatishmëri më të ulët për pranim, të anketuarit/at tregojnë për personat me orientim të ndryshëm seksual. Trendi i nevojës së lartë për distancimin shoqëror nga këta njerëz, mbetet i pandryshuar (shiko Grafikon nr. 6).

Grafiku nr.

6

Duke përdorur shkallë prej 1 (shumë pakëndshëm) deri në 10 (krejtësisht këndshëm), si do të ndjeheshit personalisht nëse keni një fqinj i cili është ...?



Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e rom/e është më i lartë tek:

- ▶ Të anketuarit/ anektuarat në moshë mbi 65 vjet, sesa te ata në moshë prej 15 deri 24 vjet;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e; dhe
- ▶ banorët/et e rrethinave urbane sesa rrethinave rurale.

Gatishmëria për të pranuar fqinj/e rom/e, rritet me moshën e të anketuarëve/ave. Në studimin e fundit gatishmëria e popullsisë së re nga 15 deri në 24 vjet është zvogëluar dhe është nën vlerën totale mesatare¹² të hulumtimit (7,5). Rezultatet tregojnë një tendencë të gatishmërisë më të madhe të pranimit të romëve te maqedonasit/et etnik/e sesa te shqiptarët/et etnik/e dhe tek banorët/et e rrethinave urbane sesa te ata të rrethinave rurale. Rezultatet, gjithashtu tregojnë një tendencë rënëse te shqiptarët/et etnik/e dhe banorët/et e rrethinave rurale (shiko tabelën nr. 8).

Tabela

8 Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e rom/e:

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7,5	7,7	7,7	7,8	8,1	8,0
2018	6,9	7,4	7,8	7,6	7,6	7,9
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	8,0		6,5			
2018	8,2		5,8			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	8,0		7,3			
2018	8,0		6,9			

Niveli i rehatisë të kesh fqinj/e një person me aftësi të kufizuara është më i lartë te:

- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë sesa te ata që kanë përfunduar arsimin fillor;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa te shqiptarët/et etnik/e; dhe
- ▶ Banorët/et rrethinave urbane se sa rrethinave rurale.

Ndjenja e rehatisë që të kesh një fqinj me aftësi të kufizuara, ndonëse një nga kategoritë me të vlerësuara në këtë studim, ende krijon dallime sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarëve/ave. Tek grupe demografiketë caktuara të cilat tregojnë gatishmëri më të ulët për pranimin e personave me aftësi të kufizuara, gjithashtu vërehet një tendencë e lehtë e rritjes së nevojës për t'u distancuar nga ata në shoqëri. Rritja e prirjes negative për pranimin e personave me aftësi të kufizuara, paraqitet më tepër në mesin: e të anketuarëve/ave me arsim fillor të përfunduar, te shqiptarët/et etnik/e dhe tek banorët/et e rrethinave rurale (shiko Tabelën nr. 9).

¹² Në Vlera mesatare ose mesatarja është mesatarja aritmetike e rezultateve të fituara nga pyetja në një shkallë prej 1 deri në 10. Mjediset më të larta aritmetike tregojnë një shkallë më të lartë të këndshmërisë dhe ato më të ulëta në një shkallë më të lartë të pakëndshmes në situatën e dhënë [pika mesatare është 5.5].

Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e një person me aftësi të kufizuara

Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	8,4	8,6	8,5
2018	7,6	8,3	8,4
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	8,8	7,4	
2018	8,6	6,9	
Vendbanimi:	Urban	Rural	
2009	8,8	8,1	
2018	8,4	7,8	

Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e një person me orientim të ndryshëm seksual:

- ▶ Femrat sesa meshkujt;
- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 35 deri 44 vjet sesa te ata në moshë mbi 65 vjet;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë dhe të mesëm, sesa te ata me arsim fillor;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave urbane se sa rurale.

Gratë janë më të gatshme të pranojnë personat me orientim të ndryshëm seksual si fqinj sesa burrat. Sipas moshës të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet janë më së paku të gatshëm. Të anketuarit/at të cilët/cilat kanë përfunduar arsim të mesëm ose më të lartë janë më të gatshëm sesa ata me arsim fillor të përfunduar, të cilat janë konsiderueshëm shumë më poshtë mesatares së përgjithshme të anketës (4,5). Shqiptarët/et etnik/e, myslimanët/et dhe banorët/et e rrethinave rurale janë nën mesataren e përgjithshme për dallim nga maqedonasit/et, krishterët/et dhe banorët/et e rrethinave urbane, që janë mbi mesataren. Hulumtimi i vitit 2018 tregon një zgjerim të hendeikut midis dy religjioneve më të mëdha dhe të anketuarëve/ave që jetojnë në rrethinat urbane dhe rurale (shiko Tabelën nr. 10).

Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e një person me orientim të ndryshëm seksual

Gjinia:	Mashkull		Femër			
2009	4,3		4,7			
2018	4,2		4,8			
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	4,8	4,6	4,5	4,3	4,4	4,1
2018	4,5	4,6	5,0	4,4	4,4	3,9
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	3,9	4,6		5,5		
2018	3,4	4,6		5,2		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	4,9		3,5			
2018	4,8		3,6			
Përkatësia religjioze:	Krishter/e		Mysliman/e			
2009	4,8		3,6			
2018	5,1		3,3			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	4,8		4,0			
2018	5,2		3,6			

Niveli i rehatisë i të pasurit person të një përkatësie tjetër etnike si fqinj/e:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë mbi 65 sesa ata në moshë prej 15 deri 24;
- ▶ Maqedonasit/et e tnik/e sesa te shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Banorët/et në rrethinat urbane sesa rurale.

Hulumtimi më i ri tregon thellim të hendekut mes maqedonasve/eve dhe shqiptarëve/eve etnik/e (shiko Tabelën nr. 11).

Niveli i rehatisë i të pasurit person të një përkatësie tjetër etnike si fqinj/e

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7,8	7,6	7,9	7,7	7,9	8,1
2018	7,9	8,0	8,2	8,1	8,0	8,3
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	8,0		7,2			
2018	8,5		7,0			
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8,1			7,5		
2018	8,4			7,8		

Niveli i të pasurit një person të një përkatësie religjioze apo të një bindjeje tjetër si fqinj/e është më i lartë te:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë mbi 65 sesa te ata në moshë prej 15 deri 24;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë dhe të mesëm, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa te shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ Banorët/et në rrethinat urbane sesa rurale.

Të tri hulumtimet, tregojnë, se të anketuarit/at më të moshuar/a se 65 vjet janë më të gatshëm të pranojnë fqinj/e të religjionit apo bindjes tjetër. E njëjta vlen edhe për ata që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë kundrejt atyre që kanë përfunduar arsimin fillor, maqedonasit/et etnik/e dhe krishterët/et krahasuar me shqiptarët/et etnik/e dhe myslimanët/et edhe ata në rrethinat urbane sesa ata në rrethinat rurale. Hulumtimi më i ri tregon thellim të hendekut mes maqedonasve/eve dhe shqiptarëve/eve etnik/e (shiko Tabelën nr. 12).

Niveli i të pasurit një person të përkatësie religjioze apo bindje tjetër si fqinj/e

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8,0	7,8	8,1	7,8	7,9	8,3
2018	7,9	8,1	8,3	8,2	8,0	8,6
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	7,7	8,0		8,6		
2018	7,7	8,3		8,4		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	8,2		7,2			
2018	8,6		6,9			
Përkatësia religjioze:	Krishter/e		Mysliman/e			
2009	8,2		7,5			
2018	8,6		7,4			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	8,3		7,5			
2018	8,4		7,8			

Niveli i rehatisë i të pasurit një person, i cili është anëtar / mbështetës i një partie tjetër politike si fqinj/e është më i lartë tek:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë mbi 65 sesa ata në moshë prej 15 deri 24;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë dhe të mesëm, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ Është konsiderueshëm më i zakonshëm te maqedonasit/et etnik/e sesa te shqiptarët etnik/e; dhe
- ▶ është më e zakonshme në rrethinat urbane sesa rurale.

Tendenca pozitive te popullata më e moshuar mbi 65 vjet, vërehet edhe te gatishmëria për të pranuar anëtar/e ose simpatizant/e të një partie tjetër politike si fqinj/e, ndërsa një tendencë negative vërehet te shqiptarët/et etnik/e, mesatarja e së cilës është nën vlerën e përgjithshme mesatare në hulumtimin. Rezultatet tregojnë gatishmëri më të madhe për pranimin e anëtarëve/anëtareve, mbështetësve nga partitë e ndryshme politike mes të anketuarëve/ave me arsim më të lartë dhe të mesëm dhe te ata të cilët jetojnë në rrethinat urbane (shiko Tabelën nr. 13).

Niveli i rehatisë i të pasurit fqinj/e anëtar/e /mbështetës/e i/e një partie tjetër politike

13 Në hulumtimet e vitit 2009 dhe 2018, të anketuarit janë pyetur: Duke shfrytëzuar shkallë prej 1 deri më 10, a do mund të me tregoni si Ju personalisht do te ishit ndjerë në secilën nga situatat e dhëna. Ne shkallen „1“ do të thotë se ndjeheni „shumë pakëndshëm“, ndërsa „10“ do te thotë se ndjeheni „krejtësisht këndshëm“ në atë situatë. Shkalla e cila shfrytëzohet në hulumtimin e vitit 2013 është ndryshuar: Duke shfrytëzuar shkallën prej 1 deri më 9, a mund të më tregoni si Ju personalisht do te ishit ndjerë në secilën nga situatat e dhëna. Ne shkallen „1“ do te thotë se ndjeheni „shumë pakëndshëm“, ndërsa „10“ do te thotë se ndjeheni „krejtësisht këndshëm“ ne atë situatë. Për këtë arsye, rezultatet e vitit 2013. merren vetëm si një indikator për identifikimin e ndryshimeve të mundshme të mëdha në strukturën e qëndrimeve në popullsi.

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8,4	8,6	8,6	8,2	8,4	8,8
2018	7,8	8,0	8,2	8,1	8,3	8,7
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	8,2	8,6		8,9		
2018	7,8	8,3		8,4		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	8,8		7,5			
2018	8,7		6,8			
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8,7			8,2		
2018	8,4			7,9		


Kur bëhet fjalë për gatishmërinë për pranimin e dallimeve në sferën publike,¹³ studimi tregon se nuk ka ndryshime drastike në shpërndarjen e përgjigjeve në mesin e të anketuarëve/ave, edhe pse në pothuajse të gjitha kategoritë, individualisht ka një tendencë të lehtë të rritjes së gatishmërisë për t'i pranuar ato.

Të anketuarit/at, në të tri hulumtimet, tregojnë ndrojtje më të vogël në lidhje me idenë që një femër të jetë bartëse e pozitës më të lartë në pushtet në shtet. E dyta me radhë, megjithëse jo aq shumë e shprehur sikur për femrën, është gatishmëria e lartë e të anketuarëve/ave për pranimin e një anëtar/e të një partie opozitare si bartës/e të asaj pozite. Menjëherë, pas kësaj është gatishmëria për të pranuar persona që i përkasin një grupi fetar apo etnik, i cili nuk i takon shumicës, e që po rritet në mënyrë progresive dhe diçka më pak se ata është gatishmëria për të pranuar personat me aftësi të kufizuara. Kur bëhet fjalë për moshën, për të anketuarit/at është akoma më e pranueshme të mbështesin një zyrtar më të ri në pozitën më të lartë në pushtet, sesa një person më të moshuar se 75 vjet. Mirëpo, gatishmëria për pranimin e personave më të moshuar ka tendencë rritëse. Ndrojtja e të anketuarëve/ave ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual është shprehur dukshëm si në sferën publike, ashtu dhe në sferën private. Edhe pse ka rritje të vogël, për të anketuarit/at më së paku e pranueshme është ideja që person me orientim të ndryshëm seksual të jetë bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet në shtet (shiko Grafikon nr. 7).

Grafiku nr.

7

Duke shfrytëzuar shkallën prej me 1 deri më 10, a do të mund të tregoni si do të ishit ndjerë nëse ndonjë person nga kategoritë që vijojnë është i zgjedhur për pozitën më të lartë të qeverisjes në shtet?



Niveli i rehatisë i të pasurit një person të gjinisë femërore si bartëse të pozitës më të lartë në pushtet është më e lartë te:

- ▶ femrat sesa të meshkujt;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ banorët/et në rrethinat urbane sesa rurale.

Gatishmëri më të madhe për pranim të femrës për bartëse të pozitës më të lartë në pushtet shprehin femrat sesa meshkujt, maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e, krishterët/et, myslimanët/et dhe banorët e rrethinave urbane sesa ato të rrethinave rurale. Në të njëjtën kohë, hulumtimi tregon një tendencë rënëse në mesin e shqiptarëve/eve etnik/e, myslimanëve/eve dhe ata të cilët janë banorë të rrethinave rurale (shiko Tabelën nr. 14).

Niveli i rehatisë i të pasurit një person nga gjinia femërore si bartëse e pozitës më të lartë në pushtet

Gjinia:	Mashkull	Femër
2009	8,6	9,2
2018	8,5	9,0
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	9,1	8,4
2018	9,2	7,4
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e
2009	9,1	8,4
2018	9,2	7,9
Vendbanimi:	Urban	Rural
2009	9,0	8,7
2018	9,0	8,3

Niveli i rehatisë i të pasurit një person me orientim të ndryshëm seksual si bartës i pozitës më të lartë në pushtet:

- ▶ femrat sesa të meshkujt;
- ▶ të anketuarit/ata me arsim më të lartë, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ banorët/et në rrethinat urbane sesa rurale.

Gatishmëri për të pranuar person me orientim të ndryshëm seksual në pozitën më të lartë në pushtet, analizuar sipas gjinisë së të anketuarëve/ave është rritur në hulumtimin e fundit dhe është më i theksuar te femrat. Gatishmëria më e madhe për pranimin të personit me orientim të ndryshëm seksual në sferën publike, rritet me arsimin dhe ka tendencë rritëse gjatë viteve. Tendencë e tillë vërehet edhe te maqedonasit/et etnik/e, krishterët/et dhe te banorët/et e rrethinave urbane (shiko Tabelën nr. 15).

Niveli i rehatisë i të pasurit një person me orientim të ndryshëm seksual si bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet:

Gjinia:	Mashkull	Femër	
2009	3,2	3,5	
2018	3,6	4,1	
Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	3,0	3,5	3,8
2018	3,1	3,9	4,4
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	3,6	2,8	
2018	4,2	2,9	
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e	
2009	3,6	2,8	
2018	4,2	3,0	
Vendbanimi:	Urban	Rural	
2009	3,6	3,0	
2018	4,6	3,0	

Niveli i rehatisë i të pasurit një person anëtarë të një pakice religjioze apo etnike në pozitën më të lartë në pushtet:

- ▶ të anketuarit/at me arsim më të lartë dhe të mesëm, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ maqedonasit/et etnik/e sesa te shqiptarët
- ▶ krishterët/et sesa myslimanët/et; dhe
- ▶ më e zakonshme në rrethinat urbane sesa rurale.

Gatishmëri më të madhe për pranim të një anëtar/e të një grupi etnik ose fetar të pakicave në pozitë më të lartë të pushtetit është më i theksuar tek ata me arsim më të lartë të përfunduar sesa tek ata me arsim fillor dhe tek të anketuarit/at me arsim të mesëm vërehet rritje. Gatishmëri më e theksuar paraqitet edhe te banorët/banoret e rrethinave urbane sesa ata në rrethina rurale. Për herë të parë, në hulumtimin e vitit 2018, maqedonasit/et etnik/e dhe të krishterët/et tregojnë gatishmëri më të madhe për të pranuar një anëtar/e të një grupi etnik ose fetar të pakicës në pozitën më të lartë në pushtet sesa shqiptarët/et dhe myslimanët/et (shiko Tabelën nr. 16 dhe Tabelën nr. 17).

Tabela

16

Niveli i rehatisë i të pasurit një person anëtarë të një pakice etnike në pozitën më të lartë në pushtet:

Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	6,7	6,4	7,1
2018	6,7	7,1	7,3
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	6,3	6,8	
2018	7,1	6,5	
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e	
2009	6,4	7,1	
2018	7,1	6,9	
Vendbanimi:	Urban	Rural	
2009	6,8	6,3	
2018	7,3	6,8	

Tabela

17

Niveli i rehatisë i të pasurit një person anëtarë të një pakice religjioze në pozitën më të lartë në pushtet:

Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	6,9	6,6	7,4
2018	6,9	7,3	7,4
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	6,6	7,0	
2018	7,4	6,6	
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e	
2009	6,6	7,2	
2018	7,4	7,0	
Vendbanimi:	Urban	Rural	
2009	7,0	6,4	
2018	7,5	7,0	

Niveli i gatishmërisë për pranim të një personi më të ri se 30 vjet si bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 34 vjet, sesa ata në moshë mbi 65 vjet;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar, sesa ata me arsim të mesëm dhe më të lartë;
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa maqedonasit/;
- ▶ Myslimanët/et sesa krishterët/et; dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave rurale sesa urbane.

Të anketuarit/at në moshë më të re prej 15 deri 34 vjet janë më të gatshëm të pranojnë person më të ri deri 30 vjet në pozitën më lartë të pushtetit, mirëpo gatishmëria zvogëlohet me moshën e të anketuarëve/ave. Të anketuarit/at me arsim fillor të përfunduar, tregojnë gatishmëri më të lartë për pranimin e një zyrtari/e më të ri/e, si dhe Shqiptar/et etnik/e, myslimanët/et dhe banorët/et e rrethinave rurale (shiko Tabelën nr. 18).

Tabela

18

Niveli i rehatisë i të pasurit një person më të ri se 30 vjet në pozitën më të lartë në pushtet:

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7,1	6,5	6,3	6,2	5,8	5,9
2018	7,6	7,0	6,6	6,4	6,3	6,1
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	6,7	6,2		6,1		
2018	7,0	6,6		6,5		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	6,0			7,6		
2018	6,4			7,2		
Përkatësia religjioze:	Krishter/e			Mysliman/e		
2009	6,0			7,2		
2018	6,3			7,4		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	6,2			6,6		
2018	6,6			6,8		

Niveli i rehatisë i të pasurit një person më të moshuar se 75 vjet e më tepër si bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 24 deri 44, sesa ata në moshë prej 15 deri 24 vjet;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa tek shqiptarët/et/etnik/e; dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave urbane sesa rurale.

Në vitin 2009 gatishmëria është më e madhe për pranim të personave më të moshuar për bartës/e të pozitës më të lartë në pushtet te meshkujt sesa te femrat. Në hulumtimin e vitit 2018 është rritur gatishmëria për pranim te të dy gjinitë, gjë që ka rezultuar me barazim të shkallës së pranimit mes femrave dhe meshkujve. Në vitin 2009 nuk është evidentuar dallim sipas përkatësisë etnike, hulumtimi i vitit 2018 tregon gatishmëri më të madhe te Maqedonas/eit sesa te Shqiptar/et. Në vitin 2009, te të anketuarit/at në moshë prej 35 deri 64 vjet është evidentuar gatishmëri më e vogël për pranimin e personave më të moshuar në sferën publike, e cila është nën mesataren e përgjithshme të hulumtimit (3,6), ndërsa gatishmëria te gjenerata më e re mes 15 dhe 34 vjet dhe më të moshuarit se 65 vjet është mbi mesataren e përgjithshme. Në vitin 2018, gatishmëri më e vogël është paraqitur te gjenerata e re mes 15 dhe 4 vjet dhe gjenerata më e moshuar mes 45 dhe 64 vjet. Gatishmëri më të madhe për pranim kanë treguar gjeneratat në moshë mes 24 dhe 44 vjet. Për të anketuarit/at e rrethinave urbane ende është më e pranueshme ideja për bartës së pozitës më të lartë në pushtet të zgjidhet person më i moshuar se 75 vjet, sesa për ata nga rrethinat rurale, me një rritje pozitive të konsiderueshme te të dy kategoritë (shiko Tabelën nr. 19).

Tabela

19

Niveli i rehatisë i të pasurit një person 75 vjet e më tepër bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet

Gjinia:	Mashkull		Femër			
2009	3,9		3,3			
2018	4,5		4,4			
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	3,7	3,7	3,5	3,4	3,5	3,8
2018	3,5	5,0	4,9	4,2	4,3	4,4
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e		Shqiptar/e			
2009	3,6		3,5			
2018	4,7		3,9			
Vendbanimi:	Urban		Rural			
2009	3,8		3,3			
2018	4,7		4,1			

Niveli i rehatisë i të pasurit një person me aftësi të kufizuara bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 25 deri 44 vjet. Sesa ata në moshë prej 15 deri 24 vjet;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë dhe të mesëm, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ Maqedonasit/e etnik/e sesa të shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Krishterët/et sesa myslimanët/et;dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave urbane sesa rurale.

Ndryshime në trendin e profilit socio-demografik të të anketuarëve/ave, ka edhe kur është në pyetje shkalla e ndrojtjes së tyre ndaj personave me aftësi të kufizuara në sferën publike. Dallimet mes gjeneratave paraqiten në hulumtimin e vitit 2018: të anketuarit/at mes 15 deri 24 vjet dhe 45 deri 54 vjet tregojnë gatishmëri më të vogël për pranimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën publike, mesatarja e së cilës është nën mesataren e përgjithshme të hulumtimit (6,5). Shkalla e pranimi rritet bashkërisht me shkallën e arsimit të përfunduar të të anketuarëve/ave. Tek ata me arsim fillor të përfunduar ka një rënie të konsiderueshme të gatishmërisë për pranim. Në vitin 2018 është vërejtur rënie e konsiderueshme e shkallës së pranimi të Shqiptarët/et etnik/e , gjë që i bën ata më të ndrojtur se Maqedonasit/et. Dallimi i njëjtë vërehet edhe mes myslimanëve/eve dhe krishterëve/eve. Banorët/et e rrethinave urbane janë më të gatshëm të pranojnë person me aftësi të kufizuara për zyrtar/e të lartë të pushtetit sesa banorët/et e rrethinave rurale, te të cilët është vërejtur një tendencë rënëse (shiko Tabelën nr. 20).

Tabela

20

Niveli i rehatisë i të pasurit një person me aftësi të kufizuara bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	6,8	6,6	6,8	6,9	6,5	6,7
2018	5,6	6,8	6,8	6,3	6,7	6,5
Arsimi:	Fillor	Të mesëm		Më të lartë		
2009	6,6	6,7		7,1		
2018	5,8	6,6		7,0		
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	6,7			6,7		
2018	6,9			5,8		
Përkatësia religjioze:	Krishter/e			Mysliman/e		
2009	6,8			6,6		
2018	6,9			5,7		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	6,9			6,4		
2018	6,9			5,9		

Niveli i rehatisë i të pasurit një person nga partia opozitare bartës/e të pozitës më të lartë në pushtet:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet, sesa ata në moshë prej 15 deri 34 vjet;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim të mesëm dhe më të lartë, sesa ata me arsim fillor;
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa Shqiptarët/et etnik/e; dhe
- ▶ banorët/et e rrethinave urbane sesa rurale.

Hulumtimi i vitit 2018, tregon gatishmëri më të vogël te gjenerata më e re (15 deri 34 vjet) për pranim të personit nga partia opozitare për pozitën më të lartë në pushtet, ndërsa më e larta te të anketuarit/at në moshë mbi 65 vjet. Shkalla e pranimit në vitin 2009 rritet me arsimin. Në vitin 2018 te të gjitha nivelet e arsimit shënohet rënie, megjithatë, të anketuarit/at me arsim fillor mbeten më të ndrojtur nga ata me arsim të mesëm dhe më të lartë. Te Shqiptarët/et etnik/e në vitin 2018, paraqitet një tendencë negative rreth gatishmërisë për pranim të një personi opozitar në pozitën më të lartë në pushtet, e cila në të gjitha hulumtimet është më e lartë te Maqedonasit/e etnik/e sesa te Shqiptarët/et etnik. Edhe te banorët/et e rrethinave urbane, gatishmëria për të pranuar është më e madhe se ato në zonat rurale (shiko Tabelën nr. 21).

Tabela

21

Niveli i rehatisë i të pasurit një person nga partia opozitare bartës/e i/e pozitës më të lartë në pushtet

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	7,8	7,6	7,7	7,7	7,9	7,9
2018	7,0	7,2	7,6	7,4	7,6	8,1
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	7,5		7,8		8,2	
2018	6,9		7,7		7,6	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8,0			6,8		
2018	8,0			5,9		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	8,1			7,3		
2018	7,8			7,1		

3.

Përvojë me diskriminim


3.1 Përvojë personale me diskriminim

Në lidhje me përvojat me diskriminimin janë parashtruar dy pyetje. E para i referohet përvojave personale me diskriminimin: "Ne 12 muajt e kaluar, a jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuar ose të ngacmuar në bazë të një apo më shumë sendeve që vijojnë"? Dhe pyetja e dytë i referohet përvojës së tyre si dëshmitar të diskriminimit: "Në 12 muajt e kaluar, a keni qenë dëshmitar kur dikush ka qenë i diskriminuar apo i ngacmuar në bazë të një apo më shumë sendeve"?

Rezultatet e hulumtimeve në pyetjen e parë, tregojnë se çdo i/e treti/tretai/e anketuar ka qenë i/e diskriminuar të paktën në një nga bazat që janë subjekt i hulumtimit (2009 – 34%; 2013 – 22%¹⁴; 2018 – 36%). Shumica, në numër pothuajse të barabartë, deklaruan se nuk ishin personalisht të diskriminuar (2009 – 65%; 2013 – 78%; 2018 – 64%) (shiko Grafikon nr. 8).

¹⁴ Rezultatet e vitit 2013 janë fituar përmes anketës telefonike. Për dallim nga anketat në terren në vitin 2009 dhe 2018, prandaj ne e përdorim atë si një tregues i cili në thelb tregon të njëjtën strukturë, por me frekuencë të ndryshme të përgjigjeve.

Ne 12 muajt e kaluar, a jeni ndjere ndonjehere te diskriminuar ose te maltretuar ne baze te nje apo me shume sendeve qe vijone?




3.2 Dëshmitar i dikujt që përjeton diskriminim

Nga ana tjetër, janë ndodhur në situatën si dëshmitarë në të paktën një forme diskriminimi 38% e të anketuarëve/ave në vitin **2009**, 31% në vitin **2013** dhe 40% në vitin **2018**. Ndërsa se nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit kanë deklaruar 60% në vitin **2009** dhe **2018**, dhe 69% në vitin **2013** (shiko Grafikon nr. 9).

Grafiku nr.

9

Ne 12 muajt e kaluar, a keni qene dëshmitar kur dikush ka qene i diskriminuar apo maltretuar ne baze te nje apo me shume sendeve?



Në tri hulumtimet, **përkatësia politike** është lloji më i shpeshtë i i diskriminimit edhe në situatat, kur të anketuarit/at janë personalisht të diskriminuar (**2009** – 18%, **2013** – 13%, **2018** – 18%) edhe kur kanë qenë në situatë si dëshmitar i kësaj forme të diskriminimit (**2009** – 25%, **2013** – 18%, **2018** – 22%). Të dhënat tregojnë se në numër më të madh të rasteve, të anketuarit/at janë gjetur në situatë të jenë dëshmitar sesa të jenë personalisht të diskriminuar sipas kësaj forme, ndryshimet e së cilës janë me tendencë të rënies së këtij fenomeni. Numër më i vogël i rasteve kur të anketuarit/at kanë qenë të diskriminuar/a është në bazë të orientimit seksual (**2009** – 1%, **2013** – 0.4%, **2018** – 3%), dhe gjithashtu në numër më të vogël rastesh janë ndodhur në situatë të jenë dëshmitarë të këtij lloji të diskriminimit (**2009** – 3%; **2013** – 7%; **2018** – 3%).

Kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të përkatësisë politike:

- ▶ Meshkujt sesa femrat; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa maqedonasit/et etnik/e.

Nga ata të cilët personalisht kanë përjetuar diskriminim, sipas përkatësisë politike, më shpesh janë meshkuj (2009 - 21%; 2018 - 20%) sesa femra (edhe në 2009 edhe në 2018 - 15%). Edhe pas nëntë vitesh, ky raport praktikisht nuk është i ndryshuar. Në bazë të përkatësisë etnike të anketuarit/at, në vitin 2009 dyfish më tepër janë paraqitur si viktima Shqiptarët/et etnik/e (30%) krahasuar me maqedonasit/et etnik/e (14%). Në vitin 2018 kjo marrëdhënie tregon një tendencë të përafritimit, përkatësisht mbi këtë bazë personalisht ishin të diskriminuar/a 22% e të anketuarëve/ave shqiptar/e etnik/e në krahasim me 18% të maqedonasve/eve etnik/e (shiko Tabelën nr. 22).

Tabela

22

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të përkatësisë politike:

Gjinia:	Mashkull	Femër
2009	21%	15
2018	20%	15
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	14%	30%
2018	18%	22%

Mesatarisht 77% e popullatës së përgjithshme, konsideron se lloji i tillë i diskriminimit është i shpeshtë kundrejt mesatarisht 15% të cilët konsiderojnë se është i rrallë. Ata të cilët deklarojnë se kanë qenë të diskriminuar në këtë bazë, 90% e konsiderojnë se është i shpeshtë dhe 8% se është i rrallë. Të dhënat tregojnë se 1 nga pesë qytetarë/e janë të bindur se janë diskriminuar në baza politike (ose kështu interpretojnë një ngjarje apo situatë në të cilën është gjetur). Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike është veçanërisht i rëndësishëm për shkak se ajo është në mënyra të ndryshme e lidhur me një çështje vitale të krijimit të kushteve për mundësi të barabarta për punësim dhe mundësi të barabarta për ndërtimin e një karriere profesionale bazuar në aftësitë, kualifikimet dhe njohuritë.

Baza e dytë e ranguar sipas përvojës personale të diskriminimit, është përkatësia etnike (2009 - 13%, 2013 - 10%, 2018 - 14%), por shumë më pak e frekuentuar krahasuar me aspektin e përkatësisë politike. Ky lloj i diskriminimit gjithashtu renditet i dyti në situatat kur të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (2009 - 15%, 2013 - 13%, 2018 - 16%).

- ▶ Meshkujt sesa femrat; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa maqedonasit/et;
- ▶ Myslimanët/et sesa krishterët/et.

Në krahasim me maqedonasit/et etnik (5%), Shqiptarët/et etnik/e (34%) konsiderueshëm më shpesh deklarojnë se janë gjetur personalisht në situatë të tillë diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike. Ky perceptim, edhe pas 9 vitesh, edhe krahas tendencës së zvogëlimit të dallimeve mes tyre, ende është konsiderueshëm më i shpeshtë në mesin e Shqiptarëve/eve etnik/e (28%) krahasuar me (7%) maqedonasëve/eve etnik/e. Në vendin tonë, në korrelacion të ngushtë janë përkatësia etnike dhe religjioze. Këtë e konfirmojnë edhe të dhënat, që tregojnë se përgjigjet e të anketuarëve/ave sipas përkatësisë religjioze janë në proporcion shumë të afërt me përgjigjet sipas përkatësisë etnike të tyre. Gjinia e të anketuarëve/ave, gjithashtu kontribuon për përvoja personale të ndryshme në fushën e diskriminimit. Sipas deklaratave të të anketuarëve/ave, te meshkujt krahasuar me femrat, ekziston një tendencë më e theksuar të deklarojnë se kanë qenë të diskriminuar në bazë të përkatësisë etnike dhe përvojat e tilla në bazë të strukturës nuk janë ndryshuar edhe pas nëntë vitesh¹⁵ (shiko Tabelën nr. 23).

Tabela

23

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të përkatësisë etnike:

Gjinia:	Mashkull	Femër
2009	15%	11%
2018	17%	12%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	5%	34%
2018	7%	28%
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e
2009	4%	32%
2018	7%	27%

Baza e tretë e ranguar sipas përvojës personale me diskriminimin është mosha (2009 – 9%, 2013 – 5%, 2018 – 12%), e cila është e treta e renditur edhe në situatat kur të anketuarit/at kanë qenë dëshmitar të diskriminimit (2009 – 9%, 2013 – 10%, 2018 – 9%).

¹⁵ Sa i përket vlerësimit nëse ka pasur ndonjë ndryshim apo jo, duhet të kemi parasysh se analizojmë segmentet e kryqëzimeve me numër relativisht të vogël të të anketuarve, në secilën prej tyre, për të cilën arsye ato duhet të shihen si indikacione, të cilat me një nivel të caktuar probabiliteti reflektojnë prirje të caktuara në përgjigjet e të anketuarve.

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të moshës:

- ▶ Të rinjtë në moshë prej 15 deri 24; dhe
- ▶ Studentët/et dhe nxënësit/et.

Përvoja personale me diskriminimin në bazë të moshës në vitin 2009 është më e shpeshtë te të anketuarit/at në moshë prej 45 deri 54 vjet dhe më e rrallë te më të moshuarit mbi 65 vjet. Në vitin 2018 ka pasur një ndryshim dhe tani më shpesh të rinjtë deklarojnë se kanë përjetuar një diskriminim të tillë, ndërsa te të anketuarit/at prej 45 deri 54 vjet ka mbetur në nivelin e njëjtë. Nga aspekti i statusit të punës, është regjistruar ndryshimi më i rëndësishëm në diskriminimin sipas moshës midis nxënësve dhe studentëve (shiko Tabelën nr. 24).

Tabela

24

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të moshës

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8%	6%	10%	12%	11%	6%
2018	18%	12%	13%	12%	10%	8%
Përkatësia etnike:	I/E punësuar	I/E papunësuar	Amvise	Student/e dhe nxënës/e	Pensionist/e	
2009	10%	9%	5%	11%	8%	
2018	12%	12%	10%	21%	8%	

Baza e katërt e ranguar sipas përvojës personale me diskriminimin, është **religjioni dhe bindja** (2009 – 6%, 2013 – 6%, 2018 – 7%), e cila është në mënyrë identike e ranguar edhe në situatat kur të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (2009 – 7%, 2013 – 10%, 2018 – 8%). Përvojat personale dhe dëshmitë për të, praktikisht nuk ndryshohen, mirëpo ka variacione të vogla midis të anketuarëve/ave, të cilët kanë qenë dëshmitarë të çfarëdo lloji të diskriminimit.

Kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të religjionit dhe të bindjes:

- ▶ Meshkujt sesa femrat;
- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 34 vjet;
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa maqedonasit/et etnik/e;
- ▶ Myslimanët/et sesa krishterët/et; dhe
- ▶ Banorët/et në rrethinat rurale sesa urbane.

Analiza e të dhënave tregon se përvojat personale me diskriminimin në bazë të religjionit dhe bindjes, janë të përcaktuara nga më tepër faktorë në bazë të të cilave mund të bëhet profili i personave dhe që personalisht janë ballafaquar me këtë lloj diskriminimi. Me një rregullsi të caktuar, mund të thuhet se karakteristikat e një personi, i cili për shkak të përkatësisë dhe bindjes së tij fetare është më shpesh i ekspozuar ndaj situatave, që ai i percepton dhe i vlerëson si diskriminuese është mashkull, nga një mjedis rural, më i ri (në moshë prej 15 deri 34 vjeç), sipas përkatësisë etnike shqiptarë e sipas përkatësisë fetare mysliman. Personat e tjerë, të cilët sipas deklaratave të tyre, më pak janë ballafaquar me këtë formë të diskriminimit, janë nga rrethinat urbane, më të moshuarit, posaçërisht ata mbi 65 vjet, sipas përkatësisë etnike Maqedonas/e, nga religjioni Krishter. E rëndësishme të theksohet, është fakti i frekuentimit relativisht të ulët të ekspozimit të diskriminimit në bazë të religjionit dhe bindjes që përfshin (6%) të të anketuarëve/ave në 2009 dhe në 2013 dhe (7%) e të anketuarëve/ave në 2018. [shiko Tabelën nr. 25].

Tabela

25

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të religjionit dhe të bindjes

Gjinia:	Mashkull			Femër		
2009	7%			5%		
2018	9%			5%		
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	8%	8%	7%	5%	4%	3%
2018	10%	12%	6%	6%	5%	2%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	2%			16%		
2018	3%			14%		
Përkatësia religjioze:	Krishter/e			Mysliman/e		
2009	2%			16%		
2018	3%			14%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	5%			7%		
2018	6%			9%		

Baza e pestë e ranguar sipas përvojës personale për diskriminim, është në bazë të gjinisë (2009 – 7%, 2013 – 5%, 2018 – 6%), e cila është e pesta e ranguar edhe në situatat kur të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (2009 – 8%, 2013 – 10%, 2018 – 6%).

Kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të përkatësisë gjinore:

- ▶ Femrat sesa meshkujt;
- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 54 vjet, sesa ata në moshë mbi 55 vjet; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa Maqedonasit/et etnik/e.

Diskriminimi në bazë gjinore, si përvojë personale, është më i shpeshtë te femrat sesa te meshkujt dhe në të dy hulumtimet (në 2009 dhe 2018) numri mbetet i pandryshuar. Në vitin 2009, të diskriminuarit sipas gjinisë në numër të barabartë janë të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 44 vjet. Në vitin 2018, përvoja personale në një numër të parëndësishëm më të madh është hasur te të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 34 vjet. Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është më i përhapur në mesin e Shqiptarëve/eve etnik/e sesa të Maqedonasëve/eve etnik/e (shiko Tabelën nr. 26).

Tabela

26

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të përkatësisë gjinore

Gjinia:	Mashkull						Femër
2009	5%						8%
2018	5%						8%
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	
2009	8%	8%	8%	7%	5%	3%	
2018	9%	9%	8%	5%	4%	2%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e						Shqiptar/e
2009	4%						14%
2018	5%						10%

Baza e gjashtë e ranguar sipas përvojës personale është diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar (2009 – 3%, 2013 – 2%, 2018 – 3%), e cila është edhe e gjashta e ranguar edhe në situatat kur të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë/e të diskriminimit (2009 – 5%, 2013 – 12%, 2018 – 5%).

Kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të aftësive të kufizuara:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 24 dhe prej 35 deri 54 vjet; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa Maqedonasit/et etnik/e.

Përvoja personale në bazë të aftësisë së kufizuar me numër të barabartë haset edhe te meshkujt edhe te femrat edhe në të dy hulumtimet. Në vitin 2009, brenda të gjitha grupmoshave është shpërndarë në mënyrë të barabartë, ndërsa në vitin 2018, një numër të parëndësishëm më të madh haset te kategoritë e moshave prej 15 deri 24 vjet dhe prej 35 deri 54 vjet. Dallim më të madh, me përvojat me diskriminimin në bazë të aftësive të kufizuara, ka sipas përkatësisë etnike të të anketuarëve/ave. Përvoja personale e tillë është më frekvente midis Shqiptarëve/eve etnik/e krahasuar me Maqedonasit/et etnik/e (shiko Tabelën nr. 27).

Tabela

27

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të aftësive të kufizuara

Gjinia:	Mashkull			Femër		
2009	3%			2%		
2018	3%			3%		
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	3%	3%	2%	2%	4%	3%
2018	4%	3%	4%	4%	2%	2%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	2%			7%		
2018	2%			6%		

Në fund të rang listës së përvojave personale me diskriminimin është orientimi seksual (2009 – 1%, 2013 – 0.4%, 2018 – 3%), e cila është e shtata e ranguar edhe në situata në të cilat të anketuarit/at kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (2009 – 3%, 2013 – 7%, 2018 – 3%).

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të orientimit seksual:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 54 vjet; dhe
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë të përfunduar.

Analiza e karakteristikave socio-demografike të të anketuarëve/ave, të cilët janë ballafaquar me diskriminim në bazë të orientimit seksual është e kufizuar për shkak se në vitin 2009 është e pranishme në numër të vogël të të anketuarëve/ave të cilët/cilat i kanë konfirmuar përvojat e tyre personale (1%), ndërsa në vitin 2013 rezultati prej 0.4%, vetëm konfirmon se qytetarët me orientim seksual të ndryshëm shmangen të flasin për problemet e tyre edhe në situata të anketimit anonim. Të dhënat e hulumtimit të vitit 2018, detektojnë rritje të dukshme të numrit të personave, të cilët flasin hapur për këtë pyetje. Nëse e shikojmë këtë seri të të dhënave në atë kontekst, në shikim të parë, arrijmë në një përfundim paradoksal . Në fakt, ky numër i rritur në vetvete është tregues i suksesit të caktuar në luftën kundër

diskriminimit në këtë fushë. Këtë e themi për arsye se orientimi seksual është i lidhur ngushtë me formimin e një personi dhe si i tillë, në periudha të shkurtra kohore, madhësia e kësaj popullësie nuk mund të rritet ose reduktohet në mënyrë drastike. Nga këtu mund të thuhet se rritja modeste e numrit të atyre, që flasin për problemet e tyre është rezultat i një ndryshimi gradual të klimës sociale, që e mundëson këtë, në princip kategoria e izoluar dhe e mbyllur e qytetarëve, të flasin më hapur për përvojat e tyre me diskriminimin. Rezultatet e hulumtimit nga viti 2018, tregojnë se ata që janë të diskriminuar në bazë të orientimit seksual, në numër të barabartë, hasen edhe te meshkujt edhe te femrat. Përvojë personale me diskriminimin në këtë bazë, kanë pasur të anketuarit në moshë prej 15 deri 54 vjet në numër të barabartë, ndërsa te kategoritë e moshave më të mëdha, praktikisht edhe nuk haset. Përvoja personale me diskriminim në këtë fushë është më frekvente te të anketuarit/ at me arsim më të lartë sesa tek ata me arsim më të ulët (shiko Tabelën nr. 28).

Tabela

28

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht diskriminim në bazë të orientimit seksual:

Gjinia:	Mashkull			Femër		
2009	1%			1%		
2018	3%			2%		
Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	2%	1%	0%	1%	1%	0%
2018	3%	4%	3%	4%	1%	0%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	1%		1%		1%	
2018	1%		2%		4%	

Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave tregoi se në numër të madh të rasteve është e lidhur përvoja personale e ekspozimit ndaj diskriminimit dhe situatat, në të cilën të anketuarit/at u gjetën si dëshmitarë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në situatë vetëm si të diskriminuar janë gjetur 10% në vitin 2009 dhe 9% në vitin 2018, situata në të cilën kanë qenë vetëm dëshmitarë, pothuajse nuk është ndryshuar (14% - 2009 - 2018). Çdo i katërti prej tyre është ndodhur në situatë edhe si i diskriminuar edhe si dëshmitarë (2009 - 24%, 2018 - 27%), ku mund të vërehet se kjo kategori e të anketuarëve/ave është rritur me 3 p.p. midis dy hulumtimeve. Shumica e të anketuarëve/ave (52% në vitin 2009 dhe 2018) deklaruan se nuk kanë qenë as të diskriminuar as dëshmitarë të diskriminimit.

Kanë përjetuar personalisht dhe kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit, më tepër:

- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë të përfunduar sesa ata me arsim fillor; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa të Maqedonasit/et etnik/e;
- ▶ Myslimanët/et sesa krishterët/et.

Analiza e më tutjeshme, tregon se konsiderueshëm më shpesh Shqiptarët/et etnik/e kanë deklaruar se kanë qenë të diskriminuar dhe kanë qenë dëshmitar sesa Maqedonasit/et etnik/e. Ky raport faktikisht nuk është ndryshuar në mënyrë strukturore. Në vitin 2018, megjithëse vërehet se numri i Maqedonasëve/eve etnik/e, që u gjenden në një situatë të tillë është rritur për 4 p.p. ndërsa në mesin e Shqiptarëve/eve etnik/e u zvogëlua me 2 p.p. Struktura e përvojave të tilla është e lidhur me përkatësinë religjioze. Të dhënat tregojnë se përkatësuesit/et e religjionit Islam në krahasim me përkatësuesit/et e religjionit Krishter, sipas deklaratave të tyre, më shpesh janë ndodhur në situatë të dyfishtë, të jenë edhe të diskriminuar edhe dëshmitarë. Arsimi, gjithashtu, është treguar si faktor, i cili dallon përvojat e tilla në drejtim të frekuncës më të madhe të përgjigjeve mes të anketuarëve/ave me arsim më të lartë në të dy hulumtimet, në 2009 dhe në 2018 (shiko Tabelën nr. 29).

Tabela

29

Ata të cilët kanë përjetuar personalisht dhe kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit

Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	22%	24%	26%
2018	21%	27%	32%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	17%	43%	
2018	21%	41%	
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e	
2009	16%	40%	
2018	21%	37%	

4.

Përvojat dhe perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë


4.1 Përvoja personale me diskriminim të shumëfishtë

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se shumica e qytetarëve/eve nuk kanë qenë të diskriminuar në asnjë mënyrë (2009 – 65%, 2013 – 78%, 2018 – 64%). Përafërsisht, në një qytetar, i cili ka qenë viktimë e ndonjë forme diskriminimi, mesatarisht vijnë dy qytetarë të cilët nuk kanë qenë të diskriminuar. Prej atyre të cilët kanë qenë të diskriminuar, një numër i madh deklarojnë se kanë qenë të diskriminuar në një formë (2009 – 17%, 2013 – 12%, 2018 – 19%). Të anketuarit/at e tjerë/a, deklaruan se ata ishin të diskriminuar në të paktën dy forma. (shiko Grafikon nr. 10).

Grafiku nr.

10

Përvoja personale me diskriminim të shumëfishtë



Në mënyrë kumulative, të diskriminuar në më së paku dy baza kanë qenë (2009 – 17% në 2013 – 10% dhe në 2018 – 17%). Do të thotë se nga numri i përgjithshëm i të diskriminuarëve, në të tri hulumtimet mesatarisht rreth 50% kanë përjetuar diskriminim të shumëfishtë, ndërsa gjysma tjetër kanë qenë e diskriminuar vetëm në një bazë.

Përvoja personale me diskriminim të shumëfishtë është më e përhapur tek:

- ▶ Të anketuarit/at me orar të shkurtë të punës;
- ▶ Të anketuarit/at në moshë më të re prej 15 deri 24;
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa Maqedonasit/et etnik/e; dhe
- ▶ Banorët/et e rrethinave rurale sesa urbane.

Sipas statusit të punës, dallimet më të mëdha në aspektin e diskriminimit të shumëfishtë janë hasur te të punësuarit me orar të shkurtër të punës, e cila me kalimin e kohës ka tendencë të zvogëlohet. Në anën tjetër më së paku diskriminimi i shumëfishtë paraqitet tek pensionistët. Në aspektin e përkatësisë etnike, Shqiptarët/et etnik/e në numër më të madh kanë deklaruar se janë ndodhur në situatë të diskriminimit të shumëfishtë krahasuar me Maqedonasit/et etnik/e. Megjithëse ekziston një tendencë rënëse te të punësuarit me orar

të shkurtër të punës dhe Shqiptarët/et etnik/e, ata ende vazhdojnë të mbeten në kulmin e shkallës së qytetarëve, të cilët kanë qenë te ekspozuar në diskriminim të dyfishtë krahasuar me të gjithë anëtarët e tjerë të të gjithë grupeve të tjera socio-demografike. Diskriminimi i shumëfishtë sipas moshës, është më i pranishëm te popullata më e re dhe më së paku janë ekspozuar në situata të tilla të anketuarit/at më të moshuar/a. Diskriminimi i shumëfishtë është pothuajse në mënyrë lineare në rënie me moshën në të dy hulumtimet (2009 dhe 2018). Sipas vendbanimit, diskriminimi i shumëfishtë është më i shpeshtë në rrethinat rurale krahasuar me rrethinat urbane dhe praktikisht nuk ka ndryshuar në vitet e fundit. (shiko Tabelën nr.30).

Tabela

30

Përvojë personale me diskriminim të shumëfishtë

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	20%	19%	18%	19%	13%	8%
2018	24%	23%	20%	14%	9%	7%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	8%			43%		
2018	12%			29%		
Vendbanimi:	Urban			Rural		
2009	14%			21%		
2018	14%			19%		
Statusi i punës:	I/E punësuar full-time	I/E punësuar part-time	I/E papunësuar	Amvise	Student/e dhe nxënës/e	Pensionist/e
2009	15%	42%	16%	20%	23%	10%
2018	18%	30%	19%	18%	21%	6%


4.2 Përvojë në diskriminim të shumëfishtë të tjerëve

Shumica e qytetarëve (60%) në periudhën e hulumtimeve (viti **2009 – 2018**) nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Numri i të cilët kanë deklaruar se kanë qenë në pozitë për të dëshmuar një formë diskriminimi është rritur për 5 p.p. nga viti 2009 krahasuar me 2018 (**2009 – 18%, 2018 – 23%**). Nga ana tjetër, numri i të anketuarëve/ave të cilët/cilat kanë deklaruar se kanë qenë dëshmitar i dy ose më shumë formave të diskriminimit, ka një tendencë të rënies (**2009 – 20%, 2018 – 17%**) (shiko Grafikon nr. 11).

Grafiku nr.

11

Përvojat si dëshmitar në diskriminim e shumëfishtë?



Përvojat si dëshmitar në diskriminim e shumëfishtë:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 15 deri 24;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë të përfunduar; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa te Maqedonasit/et etnik/e.

Gjinia e të anketuarëve/ave nuk ndikon në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë, kur janë në pozitën e dëshmitarëve. Në hulumtimet vërehet se të rinjtë në numër dukshëm më të madh në krahasim me më të moshuarit, deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të së paku dy llojeve të diskriminimit. E ngjashme është tendenca edhe sipas arsimit - te të anketuarit/at me arsim më të lartë sesa te të anketuarit/at me arsim më të ulët. Mirëpo,

me kalimin e kohës vërehet një zvogëlim të të dy kategoritë. Sipas përkatësisë etnike, Shqiptarët/et etnik/e në numër më të madh deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të më shumë formave të diskriminimit në krahasim me Maqedonasit/et etnik/e. Në hulumtimet, perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë në rolin e dëshmitarit të Maqedonasit/et etnik/e, pothuajse nuk ka ndryshuar, përderisa të Shqiptarët/et etnik/e dukshëm është zvogëluar (shiko Tabelën nr. 31).

Tabela

31

Përvojat si dëshmitar në diskriminimin e shumëfishtë

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	26%	22%	21%	22%	15%	9%
2018	25%	19%	23%	15%	11%	5%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	19%		20%		25%	
2018	9%		18%		21%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	13%			38%		
2018	15%			22%		

4.3 Perceptimi i diskriminimit të shumëfishtë


Rezultatet për perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë,¹⁶ tregojnë se konsiderueshëm ka ndryshuar. Në vitin 2009, shumica e të anketuarëve/ave (51%) kanë konsideruar se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë,¹⁷ në vitin 2018 pikëpamjet e tilla konsiderueshëm janë zvogëluar (43%) (shiko Grafikon nr. 12).

¹⁶ Pyetje për perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë nuk është parashtruar në hulumtimin e vitit 2013.

Grafiku nr.

12

A do të mund të tregoni nëse diskriminimi i shumëfishtë, sipas jush, është shumë i shpeshtë, mjaft i shpeshtë, mjaft i rrallë, shumë i rrallë ose nuk ekziston në vendin tonë?



¹⁷ Përgjigjet „shumë i shpeshtë” dhe „mjaft i shpeshtë” janë grumbulluar në kategorinë „i shpeshtë”, përgjigjet „shumë të rralla” dhe „mjaft të rralla” janë grumbulluar në kategorinë „i rrallë”.

Ndryshimet në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë, lidhen në mënyrë të konsiderueshme me përvojën e diskriminimit. Rezultatet tregojnë zvogëlim më të madh të perceptimit se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë, në mesin e të anketuarëve/ave të cilët as nuk janë të diskriminuar, as nuk kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (2009 – 43%, 2018 – 27%), një reduktim pak sa më i vogël i perceptimit të diskriminimit të shumëfishtë është vërejtur tek të anketuarit/at, të cilët vetëm kanë qenë të diskriminuar (2009 – 55%, 2018 – 47%). Perceptimi se diskriminimi i shumëfishtë është rritur konsiderueshëm në mesin e të anketuarëve/ave, që kanë qenë vetëm dëshmitarë të diskriminimit (2009 – 47%, 2018 – 56%). Përgjigjet më frekvente se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë në të dy hulumtimet, japin të anketuarit/at të cilët kanë qenë edhe dëshmitarë edhe viktimë e diskriminimit (2009 – 68%, 2018 – 66%). Kjo e dhënë tregon se pozita e dyfishtë, si dëshmitarë dhe viktimë të diskriminimit, mbështet fuqishëm përshtypjen se diskriminimi nuk është vetëm i pranishëm, por shpesh paraqitet edhe në formë të diskriminimit të shumëfishtë. Prej këtu mund të supozohet se qëndrimet ndaj diskriminimit në këtë kategori të qytetarëve, në përgjithësi do të jenë më rezistuese ndaj ndryshimeve.

5.

Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta të punësimit


5.1 Qëndrimet ndaj mundësive të barabarta të punësimit

Te të anketuarit/at „përkatësia politike“mbetet faktori kryesor diskriminues për trajtim jo të barabartë të kandidatëve/eve me kualifikime të njëjta gjatë procesit të punësimit (2009 – 67%, 2018 – 65%). Faktori “i moshës” edhe pse shënon rënie të konsiderueshme (2009 – 40%, 2018 – 30%), akoma është faktori i dytë kyç për të anketuarit/at Menjëherë pas tij është “përkatësia etnike”, i cili është faktori i tretë më i përmendur që e vë kandidatin/en në disavantazh (2009 – 28%, 2018 – 27%). Nga ana tjetër, faktorët që kanë ndikim më të vogël te të anketuarit/at në procesin e përzgjedhjes për punësim janë vendbanimi i të anketuarit/anketuarës dhe shprehitë e pirjes së duhanit (2009 – 5%, 2018 – 4%; 2009 – 6%, 2018 – 3%, përkatësisht) (shiko Grafikun nr. 13).

Grafiku nr.

13

Kur një firmë dëshiron të punësojë dikend dhe mund të zgjedhë ndërmjet dy kandidatëve me shkathtësi dhe kualifikime të njëjta, si mendoni, cili nga kriteret e cekura më poshtë e vendos njërin prej kandidatëve në pozitë më të pavoritshme?



Të gjithë të anketuarit/at, pavarësisht karakteristikave demografike, konsiderojnë se përkatësia politike është faktori më ndikues gjatë punësimit.

Nga ana tjetër, perceptimi i faktorit “të moshës” si bazë për diskriminim, krijon ndarje të popullatës sipas më tepër bazave demografike.

Mosha si faktor diskriminues në punësim, konsiderohet më shumë në mesin e:

- ▶ Të anketuarit/at në moshë prej 35 deri 64;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë se të mesëm; dhe
- ▶ Maqedonasve/eve etnik/e se sa Shqiptarëve/eve etnik/e .

Të anketuarit/at të moshës prej 35 deri 64 vjet, më shpesh mendojnë se mosha e kandidatit/es paraqet faktor diskriminues gjatë punësimit. Në anën tjetër, dukshëm është zvogëluar numri i të anketuarëve/ave me arsim të lartë të përfunduar, për të cilët mosha paraqet një faktor diskriminues gjatë punësimit. Ndarja e qëndrimeve është e dukshme te përkatësitë e ndryshme etnike. Që do të thotë Maqedonasit/et etnik/e e shikojnë moshën si bazë për diskriminim më tepër se Shqiptarët/et etnik/e. Në vitin 2018, vërehet një ulje e konsiderueshme te të dy bashkësitë etnike (shiko Tabelën nr. 32).

Tabela

32

Moshë si faktor diskriminues gjatë punësimit

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	34%	38%	45%	47%	42%	37%
2018	24%	23%	34%	34%	34%	29%
Arsimi:	Fillor		Të mesëm		Më të lartë	
2009	35%		42%		49%	
2018	27%		32%		27%	
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e			Shqiptar/e		
2009	44%			30%		
2018	33%			23%		

Përkatësia etnike e kandidatit/es si një faktor diskriminues në punësim, konsiderohet më shumë në mesin:

- ▶ Të anketuarit/ at në moshë më të re sesa më të moshuarit; dhe
- ▶ Shqiptarët/et etnik/e sesa Maqedonasit/et etnik/e.

Perceptimi i përkatësisë etnike si faktor kyç për trajtim të pabarabartë gjatë punësimit është i lidhur me moshën e të anketuarëve/ave, përkatësisht, siç rritet mosha e të anketuarëve/ave, ashtu ky perceptim zvogëlohet. Edhe pse ekziston një tendencë rënëse e të anketuarëve/ave nga bashkësia etnike Shqiptare, në perceptimin e rolit të përkatësisë etnike gjatë selektimit për punësim, megjithatë, hendeuku midis dy bashkësive më të mëdha etnike në vend rreth kësaj çështje është ende i lartë (shiko Tabelën nr. 33).

33

Përkatësia etnike e kandidatit/es si një faktor diskriminues gjatë punësimit

Grup moshat:	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
2009	33%	32%	25%	29%	19%	17%
2018	36%	35%	32%	25%	24%	16%

Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e
2009	18%	47%
2018	22%	37%

5.2 Mbështetje për masat të cilat sigurojnë mundësi të barabarta në punësim

Në të tri hulumtimet në periudhë prej 2009 deri 2018, të anketuarëve/ave u janë parashtruar një grupë pyetjesh, të cilat i referohen vlerësimit të gatishmërisë së tyre të mbështesin masa dhe aktivitete, që kanë për qëllim sigurimin e mundësive të barabarta për punësim. Futja e masave specifike, ka të bëjë me programet e veçanta për trajnimin ose kuota për grupet më pak të përfaqësuara në ëbazë të përkatësisë gjinore, etnike dhe politike, moshës, religjionit dhe bindjes, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual (veprime afirmative).

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se gatishmëria për të mbështetur masa të tilla, dominohet krahasuar me kundërshtimin për futjen e masave të tilla¹⁸ (shiko Grafikon nr. 14). Përjashtim janë vetëm masat të cilat u referohen personave me orientim të ndryshëm seksual, ku shumica e të anketuarëve/ave kundërshton futjen e masave afirmative të cilat i referohen përfaqësimit më të madh të kësaj grupe.¹⁹


¹⁸ Përgjigjet „pajtohem janë grumbullimi i përgjigjeve „krejtësisht pajtohem“ dhe „pjesërisht pajtohem“ dhe përgjigjet „kundër“ janë grumbullimi i përgjigjeve „krejtësisht kundër“ dhe „pjesërisht kundër“.

¹⁹ Në anketën telefonike të zhvilluar në vitin 2013, pa përjashtim, dominon gatishmëria për pranim për futjen e masave specifike për të gjitha kategoritë, duke i përfshirë edhe personat bazuar në orientimin e tyre seksual.

Grafiku nr.

14

A do te ishit pajtuar ose do te kishit qene kunder te futunit ne fuqi te masave specifike per sigurimin e mundesive te barabarta per punesim te te gjithë personave?



Në dy hulumtimet (2009 dhe 2018) 70% e të anketuarëve/ave mbështesin miratimin e masave specifike në bazë të moshës. Në vendin e dytë, janë masat kundër diskriminimit në bazë të aftësive të kufizuara (69%), pas të cilave vijojnë masat kundër diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike (66%). Gjithashtu, shumica e të anketuarëve/ave janë të gatshëm të mbështesin masa të tilla kundër diskriminimit të personave në bazë të gjinisë së tyre, e cila është zvogëluar nga hulumtimi i parë për 4 p.p. (2009 – 69%, 2018 – 65%). Shumica e të anketuarëve, janë gjithashtu të gatshëm të mbështesin futjen e masave specifike për personat e diskriminuar sipas religjionit dhe bindjes së tyre (2009 – 62%, 2018 – 64%), si dhe sipas përkatësisë së tyre politike (2009 – 53%, 2018 – 58%). Vetëm për personat sipas orientimit seksual, mbështetja është më e ulët në krahasim me gjithë pjesën tjetër (2009 – 40%, 2018 – 41%).

Statusi i punës i të anketuarëve/ave është një nga karakteristikat më të rëndësishme socio-demografike, kur bëhet fjalë për gatishmërinë për të mbështetur futjen e masave specifike për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë personat. Të dhënat tregojnë se gatishmëria për të mbështetur masa të tilla është shumë e ndryshueshme te personat me status të ndryshëm të punësimit. Në periudhën prej vitit 2009 deri më 2018, në kahje pozitive ndryshon qëndrimi për mbështetje mes studentëve/eve dhe nxënësve/eve. Te ata është rritur konsiderueshëm gatishmëria për mbështetje për 5 nga 7 bazat e shqyrtuara.

Numër i madh i studentëve/eve dhe nxënësve/eve tregojnë gatishmëri për të mbështetur masat në hulumtimet e fundit në vitin 2018 krahasuar me hulumtimin fillestar të vitit 2009. Këto ndryshime kanë të bëjnë me rritjen e mbështetjes për: personat në bazë të përkatësisë gjinore (2009 – 62%, 2018 – 74%), përkatësisë etnike (2009 – 59%, 2018 – 73%), të moshës (2009 – 61%, 2018 – 76%), religjionit dhe bindjes (2009 – 55%, 2018 – 77%) dhe orientimit seksual (2009 – 41%, 2018 – 53%). Ky grup është i vetëm në krahasim me të gjitha kategoritë e tjera të të anketuarëve/ave me status të punës, për shkak se në shumicë e mbështesin futjen e masave specifike kundër diskriminimit të personave në bazë të orientimit të tyre seksual. Mbështetja tek studentët/et dhe nxënësit/et është nën mesataren në vend (68%) vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por megjithatë, në shumicën e hulumtimeve, shumica e tyre (62%) mbështesin masa të tilla.

Gjithashtu, ndryshime pozitive, vërehen edhe në mesin e të punësuarve me orar të shkurtër të punës. Këto ndryshime pozitive kanë të bëjnë edhe me pesë nga shtatë kategoritë, edhe atë për: personat sipas përkatësisë etnike dhe gjinore, religjionit dhe bindjes, përkatësisë politike dhe orientimit seksual, por për secilin prej tyre rritja e mbështetjes pozitive është më e vogël në vëllim, krahasuar me studentët/et dhe nxënësit/et.

Zvogëlimi i mbështetjes për futjen e masave specifike në hulumtimet janë regjistruar te personat e papunësuar dhe pensionistët, bazuar në përkatësinë etnike dhe gjinore, ndërsa te pensionistët/et, ka gjithashtu një reduktim plotësues të mbështetjes së masave për mundësi të barabarta për personat në bazë të moshës së tyre. Nuk ka ndryshime të konsiderueshme në mbështetjen e masave të tilla në mesin e kategorive tjera të të anketuarëve/ave, sipas statusit të tyre të punës. Ajo ndryshon me devijime të parëndësishme nga mesatarja e përgjithshme e pranimit të masave të tilla në vend.

Konstatimi kryesor nga hulumtimet është se sipas profesionit të të anketuarëve/ave, vetëm te drejtorët/eshat dhe menaxherët/et, niveli i mbështetjes për futjen e masave specifike është reduktuar në vitin 2018 krahasuar me vitin 2009. Përfundimi është i ndikativ (megjithëse është një nën-popullsi e vogël statistikore), sepse për zbatimin e suksesshëm të masave

kontributi i tyre ka një rëndësi të veçantë. Tek ata, zvogëlim më të madh është kur bëhet fjalë për futjen e masave të barabarta për personat sipas përkatësisë gjinore të tyre (2009 – 73%, 2018 – 52%), pastaj për personat me aftësi të kufizuara (2009 – 79%, 2018 – 56%) dhe për personat, sipas përkatësisë etnike (2009 – 67%, 2018 – 59%) dhe zvogëlimi është më i vogël për mbështetjen e veprimeve afirmative në bazë të religjionit dhe bindjes së tyre (2009 – 64%, 2018 – 61%).


5.3 Mbështetja e masave të mbikqyrjes së punës në vend

Ekziston mbështetje në publik për masat të cilat për qëllim kanë sigurimin e mundësive të barabarta për punësimin e pjesëtarëve të bashkësive etnike më të vogla në numër. Përkatësisht, kjo mbështetje është dukshëm më e madhe krahasuar me kundërshtimin e këtyre masave. Në hulumtimin fillestar të vitit 2009, përqindja e atyre të cilët mbështesin ndjekjen e procedurave për punësim është më e lartë se përqindja e atyre të cilët mbështesin regjistrimin e përmbajtjes etnike të të punësuarve (72 % kundrejt 63 %). Në hulumtimin e vitit 2018, ky raport u ndryshua (73% kundrejt 69%) dhe dallimi midis tyre prej 9 p.p. në vitin 2009 është zvogëluar në 4 p.p. në vitin 2018. Kjo rënie është kryesisht për shkak të ndryshimeve në gatishmërinë për të mbështetur masa të tilla të dy bashkësitë më të mëdha etnike në vend (shiko Grafikon nr. 15)

Grafiku nr.

15

Deri ne cilen mase pajtoheni ose do te kishit qene kunder qe ne vendin e punes te zbatohen keto sende?



Midis Maqedonasëve/eve etnik/e është rritur gatishmëria për mbështetje për regjistrimin e përbajtjes së të punësuarve (2009 – 55%, 2018 – 64%), ndërsa të Shqiptarët/et etnik/e ka pësuar rënie. Por edhe krahas rënies mbështetja tek ata ka mbetur më e madhe në krahasim me Maqedonasit/et etnik/e dhe është konsiderueshëm mbi mbështetjen mesatare në publikun e gjerë (2009 – 63%, 2018 – 69%) (shiko tabelën nr. 34).

Tabela

34

Të evidentohet përbërja e të punësuarve që të mund të ndiqet dhe të vlerësohet sa janë të përfshirë pjesëtarët e komuniteteve etnike më të vogla		Maqedonas/e	Shqiptar/e	Drejtorë/drejtoresha dhe menaxherë/e
2018:		Gjithësej:		
Pajtohet	69%	64%	78%	68%
Është kundër	25%	30%	15%	29%
2009:		Gjithësej:		
Pajtohet	63%	55%	84%	43%
Është kundër	31%	40%	10%	54%

Krahas këtyre ndryshimeve kuantitative dhe qëndrimit të ndryshuar të drejtorët/drejtoreshat dhe menaxherët/et, kategori specifike relevante e të anketuarëve/ave, të cilët janë në mundësi reale konsiderueshëm të ndikojnë në zbatimin e suksesshëm të këtyre veprimeve afirmative. Pajtueshmëria për regjistrimin e të punësuarve të drejtorët/drejtoreshat dhe menaxherët/et është rritur konsiderueshëm në nëntë vitet e fundit (2009 – 43%, 2018 – 68%). Kjo e dhënë është në një lloj përplasje me qëndrimin se është zvogëluar pajtimi i tyre për futjen e masave specifike në bazë të përkatësisë së tyre etnike (shiko në pjesën lartë). Kjo përplasje ndoshta mund të shpjegohet me ndryshimin pas miratimit të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (vitin 2010). Në këtë kontekst, qëndrimi i drejtorëve/ drejtoreshave dhe menaxherëve/eve në lidhje me futjen e masave specifike për sigurimin e mundësive të barabarta për punësim, në përgjithësi lëviz në drejtim të raportit të kujdesshëm dhe të ndrojtur për mbështetjen e masave të caktuara specifike. Në një kontekst të tillë të ndryshuar, qëndrimin ndaj miratimit të masave specifike për të eliminuar diskriminimin kjo grupë ndërton në kuadër të një mase të përcaktuar qartë dhe në mënyrë konkrete.

Ndjekja e procedurave të cilat kanë për qëllim që personave që i përkasin bashkësive etnike më të vogla t'u sigurohen mundësi të barabarta për pranim në punë është i pranuar nga shumica e qytetarëve (2009 – 72%, 2018 – 73%). Edhe këtu në numër më të madh Shqiptarët/et etnik/e pajtohen për sjelljen e masave të tilla në krahasim me Maqedonasit/et (2009: Mak. – 66%, Alb. – 83%; 2018: Mak. – 69%, Alb. – 78%). Mbështetja të drejtorët/drejtoreshat dhe menaxherët/et ka shënuar një rritje të lehtë (2009 – 59%; 2018 – 62%) (shiko tabelën nr. 35).

Tabela

35

Të ndiqen procedurat për punësim me qëllim që personave që u përkasin komuniteteve etnike me te vogla, t'u sigurohen mundësi të barabarta të pranohen në punë, si kandidatëve të tjerë me shkathtësi apo kualifikime të ngjashme.

		Maqedonas/e	Shqiptar/e	Drejtorë/drejtoresha dhe menaxherë/e
2018		Gjithësej:		
Pajtohet	73%	69%	78%	62%
Është kundër	22%	25%	16%	30%
2009:		Gjithësej:		
Pajtohet	72%	66%	83%	59%
Është kundër	23%	29%	9%	30%

6.

Lufta kundër diskriminimit

6.1 Vlerësimi i përpjekjeve për luftën kundër diskriminimit

Përgjigjet në pyetjen nëse janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin, me kalimin e kohës kanë treguar një tendencë rënëse në vlerësim (**2009** – 46%, **2013** – 34%, **2018** – 36%) për 10 p.p. (shiko tabelën nr. 36).

Tabela

36

Marrë në përgjithësi, a do të mund të thoshit se në vendin tonë bëhen përpjekje të mjaftueshme për luftë kundër të gjitha format e diskriminimit?	Viti		
	2009	2013	2018
Bëhen përpjekje	46%	34%	36%
Nuk bëhen përpjekje	49%	59%	58%

BNë të tri hulumtimet ekziston një tendencë e vazhdueshme, të anketuarit/at të cilët konsiderojnë se diskriminimi është i shpeshtë, pavarësisht për cilin lloj të diskriminimit bëhet fjalë, në numër më të madh të vlerësojnë se nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme

për luftë kundër diskriminimit në krahasim me të anketuarit/at të cilët konsiderojnë se diskriminimi është i rrallë. Tendencë e tillë ekziston kur të dhënat shikohen përmes prizmit të përvojave me diskriminimin. Të anketuarit/at të cilët kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të diskriminimit, më shpesh konsiderojnë se nuk po bëhen përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin. Në bazë të këtyre treguesve mund të konkludohet vetëm se ekziston një tendencë për të dhënë më shpesh përgjigje negative për përpjekjet e bëra në luftën kundër diskriminimit. Me qëllim që të fitohet një imazh i qartë për arsyet e vlerësimit se nuk bëhet përpjekje të mjaftueshme në luftën kundër diskriminimit, do të fokusohemi në analizën e relacioneve mes ndërgjegjësimit dhe të drejtave në rast diskriminimi dhe vlerësimet për përpjekjet e bëra në luftën kundër diskriminimit

Analiza tregon se në rritjen e atyre 9%, të cilët kanë vlerësuar se nuk po bëhet përpjekje të mjaftueshme (2009 - 49%; 2018 - 58%), marrin pjesë me 5 p.p. përgjigjet e të anketuarëve/ave, të cilët i njohin të drejtat e tyre (2009 - 18%, 2018 - 23%). Në anën tjetër, në uljen e e numrit të të anketuarëve/ave të cilët kanë vlerësuar se nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme për 10 p.p. (2009 - 46%; 2018 - 36%), marrin pjesë 6 p.p. e përgjigjeve të atyre, të cilët nuk i njohin të drejtat e tyre dhe konsiderojnë se bëhen përpjekje të mjaftueshme (2009 - 23%, 2018 - 17%). Këto ndryshime në ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre tregojnë efektin e përgjithshëm të të gjitha veprimeve të ndërmarra nga të gjithë subjektet e përfshira në luftën kundër diskriminimit. Në fakt, egzistimi i ndërgjegjësimit të gjerë të qytetarëve/eve për të drejtat e tyre në llogari të numrit të zvogëluar të atyre që nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, ka ngritur kriterin në vlerësimin e të njejtëve për përpjekjet e bëra të shtetit në luftën kundër diskriminimit. (shiko tabelën nr. 37)

Tabela

37

Marrë në përgjithësi, a do të mund të thonit se në vendin tonë bëhen përpjekje të mjaftueshme për luftën kundër të gjitha formave të diskriminimit?

A e dini se cilat janë të drejtat e juaja në qoftë se jeni viktimë e diskriminimit?

	2009				2018			
	Po	Jo	Tjetër / Nuk e di	Gjithsej	Po	Jo	Tjetër / Nuk e di	Gjithsej
Bëhen përpjekje	21%	23%	2%	46%	18%	17%	1%	36%
Nuk bëhen përpjekje	18%	30%	1%	49%	23%	32%	3%	58%
Nuk e dinë	1%	3%	1%	5%	2%	3%	1%	6%
Gjithsej	40%	56%	4%	100%	43%	52%	5%	100%

7.

Njohja e të drejtave dhe kërkitimi mbrojtjes në rast diskriminimi


7.1 Njohja e të drejtave dhe kërkitimi mbrojtjes në rast diskriminimi

Në periudhë prej nëntë vitesh informimi i të anketuarëve/ave për të drejtat e tyre në rast se janë viktimë e diskriminimit, është rritur për 3 p.p. (2009 – 40%, 2018 – 43%)²⁰. Megjithatë, shumica e të anketuarëve/ave deklarojnë se nuk i njohin të drejtat e tyre në rast kur ata janë viktimë e diskriminimit (2009 – 56%, 2018 – 52%). Megjithëse ka një rritje të vogël në mesin e atyre që kanë deklaruar se i njohin të drejtat e tyre, ndryshimi është i vogël dhe i ngadalshëm (shiko Grafikon nr. 16).

Grafiku nr.

16

A e dini se cilat janë të drejtat e juaja në qofte se jeni viktime e diskriminimit?



²⁰ Nuk mundet me siguri të dihet nëse ndryshimet e të dhënave të cilat paraqiten në 2013, janë për shkak të ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në popullsinë ose për shkak të metodologjisë së ndryshuar, e cila është shfrytëzuar për hulumtimin (vitin 2013 metoda e anketimit ka qenë përmes telefonit, ndërsa vitin 2009 dhe 2018 është ballë për ballë në shtëpinë e të anketuarit). Për këtë arsye të dhënat e vitit 2013 për pyetjet e kësaj teme nuk merren parasysh në këtë analizë.

Ndërgjegjësimi për të drejtën në rast të diskriminimit është më i theksuar në mesin e:

- ▶ meshkujt sesa femrat;
- ▶ Të anketuarit/at me arsim më të lartë të përfunduar sesa me arsim të mesëm; dhe
- ▶ Maqedonasit/et etnik/e sesa Shqiptarët/et etnik/e;
- ▶ Krishterët/et sesa myslimanët/et.

Në pajtim me perceptimin e të anketuarëve/ave, meshkujt janë më të informuar për të drejtat e tyre në rast kur janë viktimat të diskriminimit sesa femrat. Informimi rritet me arsimin e të anketuarëve/ave. Një rënie e madhe e njohjes së të drejtave, vërehet te Shqiptarët/et etnik/e (12 p.p.) dhe te ata që i përkasin religjionit islam (9 p.p.). Për herë të parë në hulumtimin e vitit 2018, këto dy grupe në një numër dukshëm më të vogël deklarojnë se janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre për dallim nga Maqedonasit/et etnik/e dhe krishterët/et, te të cilët vërehet një rritje e informimit për të drejtat e tyre (shiko tabelën nr. 38)

Tabela

38 Njohja e të drejtave në rast të diskriminimit

Gjinia:	Mashkull	Femër	
2009	44%	37%	
2018	48%	38%	
Arsimi:	Fillor	Të mesëm	Më të lartë
2009	33%	41%	58%
2018	28%	43%	57%
Përkatësia etnike:	Maqedonas/e	Shqiptar/e	
2009	37%	50%	
2018	46%	38%	
Përkatësia religjioze:	Krishter/e	Mysliman/e	
2009	38%	48%	
2018	45%	39%	


Është e rëndësishme të theksohet sa të anketuar/a, të cilët kanë deklaruar se kanë qenë viktimë e diskriminimit (në një apo më tepër baza) në 12 muajt e fundit, kanë thënë se i njohin të drejtat e tyre. Analiza tregon ndryshime të mëdha në kahje pozitive. Në nëntë vitet e fundit dukshëm është rritur informimi i viktimave të diskriminimit për të drejtat e tyre për pothuajse të gjitha llojet e bazave të diskriminimit. Rritje më të madhe të vetëdijes ka te viktimat e diskriminimit në bazë të orientimit seksual (32 p.p.) dhe viktimat të diskriminimit në bazë të aftësive të kufizuara (16 p.p.). Rritje më e vogël, vërehet te personat e diskriminuar sipas përkatësisë gjinore (6 p.p.) dhe moshës (9). Është vërejtur rënie e informimit të atyre

që janë të diskriminuar në bazë të religjionit apo bindjes prej 16 p.p., ndërkohë që ka pak ose aspak ndryshim domethënës në ndërgjegjësimin e viktimave të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike (3 pp) dhe të përkatësisë politike (1 p.p.) (shiko Grafikon nr. 17).

Grafiku nr.

17

Ata të cilët kanë deklaruar se janë viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit (në një apo më tepër baza) dhe ata të cilët kanë deklaruar se i njohin të drejtat e tyre



Po qe se analizojmë, nëse ata që janë ndjerë si viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit, janë më të informuar ose jo, nga ata të cilët nuk kanë ndjerë se janë të diskriminuar, rezultatet nuk janë shumë optimiste. Të anketuarit/at të cilët deklarojnë se kanë qenë të diskriminuar, nuk janë në masë të madhe më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre nga ata të cilët kanë deklaruar se nuk janë të diskriminuar. Mirëpo, ndryshime vërehen tek ata të cilët kanë deklaruar se janë të diskriminuar në një bazë. Te kjo grupë, në nëntë vitet e fundit është rritur informimi për të drejtat e tyre për 11 p.p. Nga ana tjetër, informimi është zvogëluar për 4 p.p. tek ata të cilët kanë qenë të diskriminuar sipas dy apo më tepër bazave (shiko tabelën nr. 39)

Q12. A e dini se cilat janë të drejtat e juaja në qoftë se jeni viktimë e diskriminimit	Q3. Të anketuar/a të cilët personalisht kanë qenë të diskriminuar në 12 muajt e fundit			
		Nuk kanë qenë të diskriminuar	Sipas një baze	Më tepër baza
2018:				
Po	43%	42%	48%	43%
Jo	52%	53%	48%	50%
2009:				
Po	40%	40%	37%	47%
Jo	56%	56%	60%	50%


7.2 Gatishmëria për të adresuar institucionet relevante në rast të diskriminimit

Shumica e të anketuarëve/ave (57%) kanë deklaruar se do të kërkonin mbrojtje nga institucionet kompetente, nëse hipotetikisht ndodhen në situatë të jenë viktimë e diskriminimit apo shqetësimi. Një e treta prej tyre (32%), kanë deklaruar se nuk do të paraqisnin rastin. (shiko Grafikon nr. 18).

Grafiku nr.

18

Nese jeni viktime e diskriminimit ose shqetësimi, a do te kerkoni mbrojtje nga institucionet perkatese, organizatat? 2018



Gatishmëria e të anketuarëve/ave të drejtohen tek institucionet dhe organizatat kompetente për mbrojtje nga diskriminimi është shumë më e madhe tek ata, të cilët kanë qenë personalisht viktimë të diskriminimit në çfarëdo baze (71%), sesa tek ata të cilët kanë deklaruar se nuk kanë qenë të diskriminuar në 12 muajt e fundit (47%). Mirëpo, pothuajse një e katërta (23%) e atyre të cilët kanë qenë personalisht të diskriminuar, kanë deklaruar se nuk do të kërkonin mbrojtje nga asnjë institucion apo organizatë kompetente (shiko tabelën nr. 40).

Tabela		40	
Q13. Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose shqetësimit, a do të kërkonin mbrojtje nga institucionet përkatëse, organizatat?		Q12. A e dini se cilat janë të drejtat e juaja në goftë se jeni viktimë e diskriminimit?	
		Po	He
2018:			
Po	57%	71%	47%
Jo	32%	23%	41%

Analiza tregon se nuk ka dallime të mëdha mes grupeve të ndryshme të prekshme, veçanërisht të ndjeshme ndaj diskriminimit, kur është në pyetje gatishmëria e tyre të drejtohen për ndihmë dhe mbrojtje nga institucionet në shtet. Te të gjitha shtatë grupet viktimë të diskriminimit të përfshira në hulumtim, shumica prej tyre (përqindjet lëvizin prej 51% deri 63%) janë përgjigjur se do të kërkonin mbrojtje dhe diku një e treta prej tyre (përqindjet lëvizin prej 29% deri 36%) janë përgjigjur se, nëse janë ndjeshur të diskriminuar, nuk do të drejtoheshin tek institucionet kompetente për ndihmë (shiko Grafikun nr. 19).



21 Të anketuarit janë

pyetur: "Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose shqetësimit, a do të kërkonin mbrojtje nga institucionet përkatëse, organizatat?". Atyre të cilët janë përgjigjur se do të kërkonin ndihmë, u është parashtruar një pyetje e hapur: "Ku do të drejtoheni për të kërkuar mbrojtje? Po në vend tjetër? Ndonjë tjetër?" me mundësi të tregojnë më tepër institucione, të cilat u kujtohen, pa u lexuar asnjë opsion i përgjigjeve.

22 Neni 417 nga Kodi penal:

Diskriminim racor apo tjetër

Ndryshime në këtë pyetje ka te segmentet e ndryshme të popullsisë. Gatishmëria të paraqitet rasti i diskriminimit në një skenar hipotetik në qoftë se i/e anketuari/a do të ishte viktimë, është më e mundshme tek personat me arsim më të lartë (**2018**: fillor – 51%, të mesëm – 57%, më të lartë – 63%). Gjithashtu është më e theksuar te Maqedonasit/et etnik/e dhe te Krishterët/et se sa te Shqiptarët/et etnik/e dhe myslimanët/et (**2018**: maqedonas/e – 62%, Shqiptar/e – 45%, **2018**: krishter/e – 62%, mysliman/e – 47%).


Nga të anketuarit/at të cilët kanë thënë se do të kërkonin mbrojtje në rast të diskriminimit²¹ 57% (N=916), numër më i madh prej tyre do të drejtoheshin në polici (65%), që e konsiderojnë si institucion relevant dhe kompetent për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe në proporcione më të vogla, do të drejtoheshin në gjyq (47%) dhe në Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi (46%). Pastaj vijojnë Avokati i Popullit (36%), avokatë (27%) dhe organizatat qytetare (19%). Rezultatet tregojnë se kur të anketuarit/at mendojnë se ku të drejtohen për të kërkuar ndihmë në qoftë se janë viktimë e diskriminimit, institucioni i cili më së shpeshti i pari u bie ndërmend, është policia (41%), që është dyfish më tepër i përmendur se Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi (21%) dhe pothuajse trefish më tepër se Avokati i Popullit (13%). Gjyqi (9%), avokati (4%) dhe organizatat qytetare (4%), nuk janë shpesh të përmendura si zgjidhje e parë e të anketuarëve/ave. Përderisa më së shpeshti „i pari dhe i dyti i përmendur“ është gjyqi (44%) dhe pas tij është policia (29%), Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi (28%), Avokati i popullit (27%) dhe avokati (27%), më rrallë të përmendura janë organizatat qytetare (17%) dhe më së rralli e përmendur është sindikata (5%).

Është interesante të theksohet se policia është zgjedhja e parë e të anketuarëve/ave edhe pse si institucion nuk ka kompetencë për të vepruar në raste të diskriminimit (përveç në raste të racizmit dhe në raste të shkeljes së nenit 417 nga Kodi Penal²²). Nga ana tjetër, është rritur besimi në Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi te publiku i gjerë në krahasim me hulumtimin e vitit 2013 (**2013** -8%, **2018**-21%) (në vitin 2009 nuk ekzistonte si institucion) (shiko Grafikon nr. 20).

Grafiku nr.

20

Ku do të drejtoheni për të kërkuar mbrojtje?
(Ata që u përgjigjën se do të kërkonin mbrojtje – N= 916)



Te të anketuarit/at me arsim fillor dhe të mesëm të përfunduar, policia është shumë më shpesh institucioni i parë i përmendur (fillor – 48%, të mesëm – 44%), sesa te të anketuarit/at me arsim më të lartë të përfunduar (28%). Te kjo kategori e të anketuarëve/ave, më së shpeshti të parat të përmendura janë policia dhe Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi me 30%. Megjithatë Shqiptarët/et etnik/e, më shpesh deklarojnë se do të drejtoheshin të kërkojnë ndihmë prej tyre (**policia**: maq. -63%, shq. -71%; **gjyqi**: maq. -44%, shq. -60%; **Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi**: maq. -42%, shq. -58%).

Analiza tregon se policia është zgjidhja më e shpeshtë e të anketuarëve/ave, pavarësisht se a kanë deklaruar se kanë qenë viktimë e diskriminimit në 12 muajt e fundit, sipas një baze (66%) apo më tepër (69%), apo aspak nuk kanë qenë viktimë e diskriminimit (64%). Mirëpo, ata të cilët kanë deklaruar se janë viktimë e diskriminimit të shumëfishtë, në numër më të madh do të zgjidhnin gjyqin (63%) dhe Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi (59%), sesa të diskriminuarit sipas një baze (45%, përkatësisht 41%), apo ata të cilët nuk kanë qenë të diskriminuar në 12 muajt e fundit (përkatësisht 44%)²³ (shiko tabelën nr. 41)

²³ Janë treguar vetëm dallimet të cilat janë statistikisht të rëndësishme.

Tabela

39

	Q14. Ku do te drejtoheni për të kërkuar mbrojtje? (Ata që u përgjigjën se do të kërkonin mbrojtje- N= 916)	Q3. Të anketuarit të cilët kanë qenë personalisht të diskriminuar në 12 muajt e fundit		
		Nuk kanë qenë të diskriminuar	Sipas një baze	Më tepër baza
2018:				
Policia	65%	64%	66%	69%
Gjyqi	47%	44%	45%	63%
Komision për mbrojtje nga diskriminimi	46%	44%	41%	59%

8.

Përfundim

Perceptimi i diskriminimit

A n a l i z a e rezultateve nga tri hulumtimet (2009, 2013 dhe 2018) tregon se fenomeni i diskriminimit është gjerësisht i përhapur në mesin e popullatës, me një tendencë të lehtë rritëse. Të dhënat vazhdimisht tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarëve/ anketuarave, të cilët konsiderojnë se diskriminimi është i shpeshtë, për dallim nga ata të cilët nuk pajtohen me këtë qëndrim dhe mendojnë se është i rrallë. Megjithatë, gjatë viteve, ekziston një tendencë stabile rritëse e perceptimit mes të anketuarëve/ anketuarave se egzistimi i diskriminimit është i rrallë. Këto ndryshime sjellin deri te rritja e perceptimeve publike se diskriminimi në vend ekziston, në llogari të të reduktimit të perceptimit se diskriminimi nuk ekziston.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe etnike është më i përhapur. Këto të dhëna tregojnë se publiku i njeh ata si "gjeneratorët" kryesorë, të cilët paraqesin një pengesë në realizimin emundësive të barabarta të qytetarëve/eve në sfera të ndryshme të jetës. Të dhënat tregojnë se në numër më të madh të rasteve si viktimë apo dëshmitarë të diskriminimit paraqiten persona të cilët janë vënë në pozitë të pavolitshme vetëm në bazë të përkatësisë politike apo etnike të tyre. Për më tepër, sipas vlerësimit të të anketuarëve/ave, në krye të listës së faktorëve që i vënë kandidatët/et me aftësi dhe kualifikime të barabarta në një pozitë të pabarabartë në punësim, është pikërisht përkatësia e tyre politike dhe etnike.

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual sipas perceptimit të publikut është në fund të rang listës, si më së paku i përhapur. Megjithatë ka një rritje të vazhdueshme të numrit të të anketuarëve/ave që e njohin këtë lloj diskriminimi. Ky trend tregon se ambienti i përgjithshëm në vend po ndryshon në drejtim të ngritjes së vetëdijes për këtë lloj diskriminimi. Mirëpo, rritja e ndërgjegjësimit nuk është në korrelacion me gatishmërinë reale për të ndryshuar

qëndrimet ndaj këtij grupi të një pjesë e konsiderueshme e publikut. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në jetën reale ekziston distancim i lartë social nga personat me orientim të ndryshëm seksual. Në fund të listës së pranimit si fqinj/e apo mik/e është pikërisht kjo grupë, gjithashtu për këtë kategori të personave gatishmëria është më e vogël për mbështetjen e masave specifike për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit.

Aspekt të veçantë të perceptimeve të diskriminimit paraqesin vlerësimet e të anketuarëve/ave, nëse një formë e veçantë e diskriminimit është më e shpeshtë apo më e rrallë krahasuar me pesë vjet më parë. Sipas këtij parametri, rezultatet tregojnë se perceptimi i diskriminimit si më i shpeshtë, me tendencë reduktimi. Kjo është pasojë e rritjes së numrit të qytetarëve, të cilët vlerësojnë se situata ka mbetur e pandryshuar. Nga ana tjetër, çdo i/e katërt/a i/e anketuar është i/e bindur se diskriminimi është më i rrallë. Përmes prizmës së këtyre rezultateve mund të vlerësohet efektet nga veprimet e ndërmarura në luftën kundër diskriminimit. Analiza e strukturës dhe e dinamikës së ndryshimeve, tregon se rezultatet më të mira në luftën kundër diskriminimit janë arritur në lidhje me diskriminimin në bazë të: moshës, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë. Vetëm për këto forma të diskriminimit dominon vlerësimi se është më pak i rrallë në pesë vitet e fundit. Këto gjetje, konfirmojnë rezultatet se shumica e qytetarëve/eve janë të gatshëm/me të mbështesin futjen e masave specifike për të siguruar mundësi të barabarta punësimi për personat me aftësi të kufizuara, gjininë të ndryshme dhe moshë.

Perceptimi më i pafavorshëm i diskriminimit në afat të mesëm (në pesë vitet e fundit) është në aspektin e përkatësisë politike. Pesë herë më i lartë numri i të anketuarëve/ave që konsiderojnë se ky lloj i diskriminimit është më i shpeshtë se ata të cilët e vlerësojnë atë si më të rrallë. Ky dallim drastik midis perceptimeve të diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, krahasuar me të gjitha të tjerat, shihet nga fakti se në diskriminimin e dytë të renditur sipas përkatësisë etnike, dominimi i perceptimit se është më i shpeshtë është vetëm për 1.3 herë më i lartë në krahasim me vlerësimin se diskriminimi është më i rrallë.

Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se qytetarët/et deklarojnë një nivel të lartë të tolerancës anketuarëve/ave edhe kur bëhet fjalë për sferën private, përkatësisht për bashkëjetesën me fqinj të cilët i përkastin grupeve të ndryshme. E njëjtë pasqyrohet edhe në sferën, kur bëhet fjalë për pranimin e pjesëtarëve/eve të grupeve të ndryshme në pozitën më të lartë zgjedhore në pushtet. Në shkallën e tolerancës ndaj grupeve të ndryshme, të anketuarit/at tregojnë gatishmëri të madhe për të pranuar si fqinj dhe si bartës të pozitës më të lartë zgjedhore, anëtarë/e të përkatësive politike "të tjera" dhe anëtarë të bashkësive etnike "të tjera". Këto të dhëna janë në një korrelacion negativ me të dhënat mbi diskriminimin e përhapur në bazë të diskriminimit politik dhe etnik. Marrëdhënie të tilla ndërmjet këtyre parametrave, tregojnë se dëshira sociale për një përgjigje tolerante në hulumtime, mund të ketë një ndikim të madh. Gjatë analizimit të rezultateve të hulumtimit, një tendencë e tillë për të dhënë përgjigje pozitive krijon mundësi për formimin e një imazhi më pozitiv për nivelin e tolerancës ndaj "të tjerëve" në shoqëri, sesa ajo ekziston në të realitet.

Në zonën negative të "barometrit" të tolerancës, ndrojtja ndaj njerëzve me orientim të ndryshëm seksual shprehet qartë, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Një emërues i përbashkët i të dhënave në lidhje me perceptimin për orientimin seksual, gjatë të gjitha temave dhe aspekteve të studimit, është se kanë një shenjë negative. Në bazë të këtyre gjetjeve, mund të thuhet se integrimi i këtij grupi paraqet një nga sfidat më të mëdha në luftën kundër diskriminimit.

Përvoja e diskriminimit

Të dhënat për përvojat personale të diskriminimit tregojnë se çdo i/e treti/a i/e anketuar ishte viktimë e diskriminimit, ndërsa katër nga dhjetë të anketuar/a ishin dëshmitarë/e të diskriminimit. Në të gjitha hulumtimet (2009, 2013 dhe 2018), përkatësia politike është perceptuar si lloji më i shpeshtë i diskriminimit dhe në situatat kur personat kanë qenë personalisht të diskriminuar edhe kur kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Baza e dytë e renditur për përvojë personale me diskriminimin, e cila është dukshëm më pak e zakonshme se përkatësia politike, është diskriminimi sipas përkatësisë etnike. Në jetën e përditshme në numër të madh rastesh tregohet lidhshmëria mes përvojës personale të ekspozimit ndaj diskriminimit dhe situata, në të cilën ata e gjetën veten si dëshmitarë të të njëjtave. Kjo përvojë e dyfishuar e diskriminimit, ndikon dukshëm në perceptimin e tyre për egzistimin e diskriminimit. Këtë e konfirmojnë të dhënat, përkatësisht në numër dukshëm më të madh, këta persona e perceptojnë diskriminimin si të shpeshtë në krahasim me të gjitha kategoritë e tjera të të anketuarëve/ave. Kjo gjetje duhet të përdoret për të synuar njerëzit me përvoja të tilla nga organizatat fokusi i të cilave është lufta kundër diskriminimit, me qëllim që prej tyre të fitohen informacione specifike dhe konkrete të cilat mund të kontribuojnë për rezultate më të mira në luftën kundër diskriminimit.

Gjysma e personave që deklaruan se ishin të diskriminuar, ishin nënshtruar diskriminimit të shumëfishtë. Kjo praktikisht do të thotë se pothuajse çdo qytetar/e i/e pestë në vend deklaroi se ai/ajo ka qenë subjekt i diskriminimit të shumëfishtë dhe numri i tyre nuk ka ndryshuar gjatë viteve. Nga ana tjetër, të dhënat për perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë tregojnë tendencë të konsiderueshme rënëse. Përvoja me diskriminimin ka një ndikim të rëndësishëm në perceptimin e diskriminimit të shumëfishtë. Rënie më të madhe në perceptimin se diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë, ka në mesin e të anketuarëve/ave të cilët nuk janë as të diskriminuar, as dëshmitarë të diskriminimit. Nga ana tjetër, përgjigjet më me frekuencë që diskriminimi i shumëfishtë është i shpeshtë, raportohen nga të anketuarit/at të cilët/cilat kanë qenë edhe dëshmitarë/e edhe viktimë të diskriminimit.

Qëndrimi ndaj mundësive të barabarta në punësim

Analiza e perceptimeve të të anketuarëve/ave tregon se tre faktorë kryesorë të cilët çojnë në trajtim të pabarabartë gjatë punësimit: përkatësia politike, moshja e kandidatëve/eve dhe përkatësia etnike e tyre. Nga ana tjetër, hulumtimi konfirmon se gatishmëria për të mbështetur masat specifike për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit të anketuarit/at u japin personave në bazë të: moshës së kandidatëve/eve, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë etnike. Fakti që mbështetja për sigurimin e mundësive të barabarta gjatë punësimit, në një shkallë të lartë përputhen me faktorët kyç që reduktojnë mundësitë e barabarta të punësimit, tregon që diskriminimi në punësim ndikon në interesat ekzistenciale dhe socio-ekonomike të qytetarëve/eve. Këto gjetje mbështeten në gatishmërinë e shprehur të shumicës së qytetarëve/eve për të mbështetur masat për mbajtjen e shënimeve dhe monitorimin e procedurave gjatë punësimit të personave që u përkasin komuniteteve më të vogla etnike. Ashtu sikurse për aspektet tjera të diskriminimit, edhe në këtë rast, barazia e personave me orientim të ndryshëm seksual është lënë pas dore dhe vetëm çdo i/e pesti/a e të anketuarëve/ave, mbështet masat për veprim të barabartë gjatë punësimit të këtyre individëve.

Luftima kundër diskriminimit

Vlerësimi i qytetarëve/eve lidhur me përpjekjet e mjaftueshme për të luftuar diskriminimin, me kalimin e kohës tregon një tendencë rënëse në vlerësimin se janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të luftuar diskriminimin.

Arsyeja kryesore për këtë prirje është tendenca e vazhdueshme e konfirmuar në të tri hulumtimet (2009, 2013 dhe 2018) se numër i madh i të anketuarëve/ave konsiderojnë se diskriminimi është i shpeshtë, duke vlerësuar se nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme kundër të njëjtës, krahasuar me të anketuarit/at që konsiderojnë se diskriminimi është i rrallë. Tendenca e njëjtë ekziston kur të dhënat shihen përmes prizmit të përvojave me diskriminimin. Të anketuarit/at të cilët janë diskriminuar ose që kanë qenë dëshmitarë, më shpesh përgjigjen se nuk po bëhen përpjekje të mjaftueshme në luftën kundër diskriminimit.

Njohja e të drejtave në rast diskriminimi

Gjatë periudhës së mbuluar nga hulumtimet, prej 2009 deri në vitin 2018, shumica e të anketuarëve/ave deklarojnë se nuk i njohin të drejtat e tyre në rast se janë viktimat të diskriminimit. Sidoqoftë, mund të vërehet si një efekt pozitiv në luftën kundër diskriminimit. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se rritet numri i të anketuarëve/ave të cilët kanë njohuri për të drejtat e tyre mes atyre të cilët kanë qenë viktimë e diskriminimit.

Gatishmëria e të anketuarëve/ave për t'u drejtuar institucioneve dhe organizatave kompetente për mbrojtjen nga diskriminimi është shumë më e lartë në mesin e atyre që ishin viktimat të diskriminimit, krahasuar me ata që deklaruan se nuk ishin. Nga të anketuarit/at të cilët deklaruan se do të kërkonin mbrojtje nëse do të ishin viktimat të diskriminimit, më frekvente është përgjigjja se do të drejtoheshin në polici, të cilën e konsiderojnë si një institucion relevant, kompetent për mbrojtjen nga diskriminimi dhe në përmasa disi më të vogla, ata do të drejtoheshin te gjykata, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pastaj tek Avokati i Popullit, avokati dhe organizatat civile. Struktura e këtyre përgjigjeve tregon për përfundimin se, de facto, një pjesë e madhe e qytetarëve/eve nuk i njohin institucionet përkatëse kundër diskriminimit, megjithëse janë subjektivisht të bindur se i njohin ato. Kjo tregon se nevojitet një publicitet më i madh në publik në të institucioneve kompetente në luftën kundër diskriminimit, sidomos Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, Avokati i popullit dhe gjyqi.

Ndikimi i kontekstit social në qëndrimet për diskriminimin

Analiza e kontekstit shoqëror dhe ndërveprimeve mes grupeve të ndryshme shoqërore, tregon se shumica dërrmuese e qytetarëve/eve, anëtarët/et e grupeve të ndryshme shoqërore i konsiderojnë si pjesë të rrethit të tyre shoqëror. Shumica e të anketuarëve/ave kanë deklaruar se kanë mik/e apo të njohur/a më qëndrime të ndryshme politike, ose përkatësi tjetër etnike apo religjioze të ndryshme nga ata. Gjithashtu, tre nga pesë të anketuar/a janë përgjigjur se kanë mik/e apo të njohur/a nga bashkësia etnike rome dhe person me aftësi të kufizuara. Në kontrast, vetëm një në dhjetë të anketuar/a ka deklaruar

se në rrethin më të ngushtë ose më të gjerë shoqëror ai/ajo takon persona me orientim të ndryshëm seksual. Për më tepër, analiza tregon se më frekvente janë përgjigjet se diskriminimi është më i shpeshtë në mesin e atyre me një radius më të gjerë të kontakteve sociale. Duke u bazuar në këto gjetje, një përfundim i përgjithshëm mund të bëhet nga hulumtimi sipas të cilit, perceptimet dhe qëndrimet ndaj diskriminimit në mesin e publikut do të jenë të përhapura përderisa ka arsye për të parashikuar diskriminim në baza politike dhe etnike. Fokusi i luftës kundër perceptimit të përhapur të diskriminimit në vendin tonë, duhet të vendoset në hulumtimin e thellë të faktorëve që përcaktojnë qëndrime të tilla.

Shtojca 1 - Metodologjia e aplikuar në hulumtim

Tre hulumtimet u zhvilluan prej vitit 2009 deri më 2018, në distancë kohore prej rreth 5 vitesh. Të dhënat nga hulumtimi i parë janë fituar në mes 9 dhe 15 prillit të vitit 2009, nga hulumtimi i dytë mes 10 dhe 27 shtatorit të vitit 2013 dhe nga hulumtimi i fundit mes 5 dhe 17 shtator të vitit 2018.

Hulumtimi i parë (2009) dhe i treti (2018) janë zhvilluar nga Agjencia për hulumtim të mendimit publik, marketing dhe media BRIMA, duke shfrytëzuar metodologjinë e njëjtë dhe dizajn të shembullit. Të dy anketat ishin reprezentative në shkallë kombëtare në moshë prej +15 vjet, duke shfrytëzuar metodën e anketimit "ballë për ballë" në shtëpinë e të anketuarit. Intervistat u zhvilluan në gjuhën Maqedonas/ee (për të anketuarit Maqedonas/e etnik dhe të tjerët të përkatësisë të grupeve më të vogla etnike) dhe në gjuhën shqipe (për të anketuarit shqiptar etnik). Në shembullin e vitit 2009 janë përfshirë N = 1606 të anketuar/a dhe në 2018 janë N = 1607 të anketuar, me një diferencë gabimi prej $\pm 2.5\%$ me një nivel 95% të besueshmërisë. Dizajni i shembullit i aplikuar në hulumtimet është një mostër e rastit e shtresuar shumëshkallëshe.

Faza e parë: Shpërndarja e „pikave të shembullit“ (sampling points) në mënyrë proporcionale në rajone, urban/rural dhe karakteristikat etnike të popullatës - duke zbatuar metodën PPS (probability proportion to size) d.m.th. proporcioni i probabilitetit të madhësisë.

Faza e dytë: Përzgjedhja e familjeve, duke përdorur metodën e rastit. Çdo "sektori" i është caktuar një pikënisje dhe drejtim.

Faza e tretë: Zgjedhja e vetëm 1 të anketuari për amvisëri me shfrytëzimin e çelësit për selektim, "ditëlindja e parë e ardhshme", i cili është një person në familje në moshën 15 vjeç ose më shumë, ditëlindja e të cilit është e ardhshme.

Faza e katërt: Ndryshimi i amvisërisë, duke përdorur një procedurë të përzgjedhjes së amvisërisë, nëse anëtari i përzgjedhur i amvisërisë refuzon ose nuk është i gatshëm për pjesëmarrje në një intervistë pas tre tentimesh (vizita fillestare dhe dy vizita tjera).

Mostrat janë përgatitur duke përdorur të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikës (rezultatet nga regjistrimi i vitit 2002) për popullsinë e moshës 15 vjeç e sipër. Mostra, gjithashtu, përfshiu strukturën e popullsisë sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, përbërjes etnike dhe rajonit dhe u përditësua në përputhje me vlerësimet më të fundit dhe të dhënat primare të Entit Shtetëror të Statistikës për popullatën e vendit, të përpunuara nga BRIMA. Baza e të dhënave është përshtatur sipas moshës dhe gjinisë, rajonit dhe përkatësisë etnike.

Hulumtimi i dytë (2013) është realizuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, në bashkëpunim me M-prospekt DOO - Shkup. Hulumtimi është kryer përmes telefonit (80% përmes telefonisë dhe 20% nga telefonat celularë, duke përdorur bazën vetanake të numrave të telefonit në M-prospekt), duke përdorur metodën "ditëlindja e parë e ardhshme" e +15 popullatës. Metoda e dizajnit të shembullit ishte shumëshkallëshe, duke marrë parasysh shpërndarjen e popullatës, sipas vendbanimit në rrethinat rurale dhe urbane dhe përkatësisë etnike. Mostra përfshinte 1600 të anketuar, me një diferencë gabimi prej $\pm 2.5\%$ me një nivel 95% të besueshmërisë.

Probleme metodologjike

Pyetësi është shfrytëzuar në tre hulumtimet me qëllim që të arrihet njohuri për ndryshimet e perceptimeve, qëndrimeve, njohurive dhe të vetëdijes për diskriminimin, me ndryshime të caktuara në disa nga pyetjet në hulumtimin e vitit 2013.

Në vitin 2013 janë bërë ndryshime në pyetjet vijuese:

- ▶ Në pyetjen P2 u largua opsioni: "as më e shpeshtë, as më e rrallë" në përgjigjet.
- ▶ Pyetjet P5, P7, P_1 dhe P10_2 nuk u parashtruan në pyetësor.
- ▶ Shkalla e matjes e përdorur për pyetjet P6 dhe P8 ishte ndryshuar prej 1-10 në 1-9 shkallë.
- ▶ Në pyetjen P9 një opsion i ri u shtua: "as pajtohem as nuk pajtohem".
- ▶ Në P13 nuk u përdor asnjë filtër.

Këto ndryshime në pyetësor kufizuan mundësitë për krahasimin e rezultateve të të tri hulumtimeve.

Gjithashtu pyetje të reja (P13 dhe P14) janë shtuar nga hulumtimi i vitit 2013 për monitorim të ndikimit dhe progresit të Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, gjithashtu edhe matjen e vetëdijesimit për Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, të sapoformuar si organ qendror kombëtar të këtij ligji.

Shtojca 2 -

Pyetëtori i hulumtimit

[lexohet para se te fillohet me pyetjen e pare]

Pyetjet qe vijojne kanë të bëjnë me temën e diskriminimit.

Me nocionin diskriminim nënkuptohet trajtim jo i barabartë i njerëzve, ose sjellje e ndryshme ndaj njerëzve vetëm për shkak se janë femra apo meshkuj, pjesëtarë të ndonjë grupi apo bashkësie të caktuar etnike, i takojnë ndonjë besimi të caktuar, janë me handicap (përkatësisht personat me aftësi të kufizuara mendore ose fizike) etj. Trajtimi jo i barabartë, mund të jetë i dukshëm, si për shembull, kur me qëllim lëshohet shpallje për punë, në të cilën ceket se kërkohen punëtorë nga një grup etnik të caktuar ose vetëm meshkuj. Po ashtu, trajtimi jo i barabartë mund të jetë i fshehur, si për shembull, ne qoftë se mbahej testim për punë gjate ndonjë feste fetare për shkak të së cilës nuk do mund të ishin prezent pjesëtarët e një konfesionit.

SHOUKARTA Q1

Q1. A do të mund të më tregoni se çfarë mendoni, sa e shpeshtë është secila nga format e cekura të diskriminimit në shtet? Diskriminim në bazë të...

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NE SECILIN RRESHT	Shumë e shpeshte	Mjaft e shpeshtë	Mjaft e rrallë	Shume rrallë	Nuk ekziston	Nuk e di (nuk lexohet)
Q1_1 Përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	9
Q1_2 Gjinisë	1	2	3	4	5	9
Q1_3 Orientimit seksual (p.sh. me orientim të ndryshëm seksualiteti)	1	2	3	4	5	9
Q1_4 Moshës	1	2	3	4	5	9
Q1_5 Religjionit ose bindjes	1	2	3	4	5	9
Q1_6 Handikap (aftësisë së kufizuar mendore ose fizike)	1	2	3	4	5	9
Q1_7 Përkatësisë partiake	1	2	3	4	5	9

SHOUKARTA Q2

Q2. Nëse e krahasoni situatën e tanishme me atë prej para pesë vitesh, a do kishit thënë se format e diskriminimit që vijojnë janë më të shpeshta apo më të rralla në shtet? Diskriminim në bazë të...

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NE SECILIN RRESHT	Shumë më e shpeshtë	Mjaft më e shpeshtë	As më e shpeshte, as më e rralle (e njëjte)	Mjaft më e rralle	Shume më e rralle	Nuk e di (nuk lexohet)
Q2_1 Përkatësisë etnike	1	2	3	4	5	9
Q2_2 Gjinisë	1	2	3	4	5	9
Q2_3 Orientimit seksual (p.sh. me orientim të ndryshëm seksualitet)	1	2	3	4	5	9
Q2_4 Moshës	1	2	3	4	5	9
Q2_5 Religjionit ose bindjes	1	2	3	4	5	9
Q2_6 Handikap (aftësisë së kufizuar mendore ose fizike)	1	2	3	4	5	9
Q2_7 Përkatësisë partiake	1	2	3	4	5	9

SHOUKARTA Q3

Q3. Ne 12 muajt e kaluar, a jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuar ose të ngacmuar në bazë të një apo më shumë sendeve, si vijojnë? A keni qenë të diskriminuar në bazë të...? Ju lutem t'i shënoni të gjitha ato, të cilat mendoni se janë relevante.

MË SHUMË PËRGJIGJE JANË TË MUNDSHME		
Q3_1	Përkatësisë etnike	1
Q3_2	Gjinia:	2
Q3_3	Orientimit seksual (p.sh. me orientim të ndryshëm seksualitet)	3
Q3_4	Moshës	4
Q3_5	Religjionit ose bindjes	5
Q3_6	Handikap (aftësisë së kufizuar mendore ose fizike)	6
Q3_7	Përkatësisë partiake	7
Q3_8	Shkruaj shkak tjetër	8
Q3_98	Nuk keni qenë të diskriminuar (NUK LEXOHEJ)	98
Q3_99	Nuk e di (NUK LEXOHEJ)	99

SHOUKARTA Q4

Q4. Ne 12 muajt e kaluar, a keni qenë dëshmitar kur dikush ka qenë i diskriminuar apo i ngacmuar, në bazë të një apo me shume sendeve? A ka qenë ai diskriminim në baze të...? Ju lutem t'i shënoni të gjitha ato, të cilat mendoni se janë relevante.

MË SHUMË PËRGJIGJE JANË TË MUNDSHME		
Q3_1	Përkatësisë etnike	1
Q3_2	Gjinia:	2
Q3_3	Orientimit seksual (p.sh. me orientim të ndryshëm seksualitet)	3
Q3_4	Moshës	4
Q3_5	Religjionit ose bindjes	5
Q3_6	Handikap (aftësisë së kufizuar mendore ose fizike)	6
Q3_7	Përkatësisë partiake	7
Q3_8	Shkruaj shkak tjetër	8
Q3_98	Nuk keni qenë dëshmitar të diskriminimit (NUK LEXOHE)	98
Q3_99	Nuk e di (NUK LEXOHE)	99

SHOUKARTA Q5

Q5. Sapo biseduam për diskriminim në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, religjionit apo bindjes dhe/ose handikap (aftësisë së kufizuar mendore ose fizike). Njerëz të caktuar mund të ndjejnë diskriminim në bazë të më shumë sendeve. Kur njerëzit janë të diskriminuar në bazë të më shumë sendeve, atë e quajmë "diskriminim të shumëfishtë". A do të mund të më tregoni se a është diskriminimi i shumëfishtë, sipas jush, shumë i shpeshtë, mjaft i shpeshtë, mjaft i rrallë, shume i rrallë ose nuk ekziston në shtet?

LEXONI	
Shume i shpeshtë	1
Mjaft i shpeshtë	2
Mjaft i rrallë	3
Shumë i rralle	4
Nuk ekziston	5
Nuk e di (NUK LEXOHE)	9

SHOUKARTA Q6

Q6. Duke shfrytëzuar shkallët prej 1 deri më 10, a do mund të më tregoni Ju personalisht si do te ishit ndjerë në secilën nga situatat e dhëna. Në shkallën „1“, do të thotë se ndjeheni „shumë pakëndshëm“, ndërsa „10“, do te thotë se ndjeheni „krejtësisht këndshëm“ në atë situatë.

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NË SECILIN RRESHT	Shumë pakëndsh- ëm	2	3	4	5	6	7	8	9	Krejtës- isht këndsh- ëm	Indif.	Nuk e di (NUK LEXOHET)
Q6_1 Nëse keni fqinj që është rom	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q6_2 Nëse keni fqinj që është i handicap (person me aftësi të kufizuar mendore ose fizike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q6_3 Nëse keni fqinj që është me orientim të ndryshëm seksual (gej burrë apo lesbike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q6_4 Nëse keni fqinj të ndonjë përkatësie etnike tjetër, e ndryshme nga e juaja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q6_5 Nëse keni fqinj të ndonjë religjioni apo bindjeje tjetër, të ndryshme nga e juaja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q6_6 Nëse keni fqinj që është pjesëtar apo simpatizues i ndonjë partie politike tjetër, e ndryshme nga ajo që ju e simpatizoni apo në të cilën jeni anëtar.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99

Q7. Në shtet, kur një firmë do të punësojë dikë dhe mund të zgjedhë në mes të dy kandidateve me shkathtësi dhe kualifikime të njëjta, si mendoni, cili nga kriteret e cekura më poshtë e vë njërin prej kandidatëve në pozitë më të pavoritshme? (në bazë të çka, firma do të marrë vendim, cilin nga dy kandidatët të mos e pranojë)

LEXONI; ROTONI MË SHUMË PËRGJIGJE JANË TË MUNDSHME		
Q7_1	Emri i kandidatit	1
Q7_2	Adresa e kandidatit	2
Q7_3	Mënyra se si kandidati flet, theksi i tij/i saj	3
Q7_4	Përkatësia etnike e kandidatit	4
Q7_5	Gjinia e kandidatit	5
Q7_6	Orientimi seksual i kandidatit (për shembull, nëse është me orientim të ndryshëm seksual)	6
Q7_7	Mosha e kandidatit	7
Q7_8	Ndonjë handicap (aftësia e kufizuar mendore ose fizike)	8
Q7_9	Shprehja e bindjeve religjioze (për shembull, të mbajturit dukshëm të ndonjë simboli religjioz)	9
Q7_10	Përkatësia partiake	10
Q7_11	A është kandidati duhanpirës apo jo	11
Q7_12	Pamja e jashtme e kandidatit, mënyra e veshjes dhe dukja	12
Q7_13	Dukja e përgjithshme fizike e kandidatit (lartësi, peshë, fytyrë etj.)	13
Q7_14	Shkruaj tjetër	14
Q7_98	Asgjë nga te cekurat (NUK LEXOHEJ)	98
Q7_99	Nuk e di (NUK LEXOHEJ)	99

SHOUKARTA Q8

Q8. Duke shfrytëzuar shkallë nga 1 deri më 10, a do të mund të më tregoni si do te ishit ndjerë nëse ndonjë person nga kategoritë që vijojnë është i zgjedhur për pozitën më të lartë të qeverisjes në vendin tonë?

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NË SECILIN RRESHT	Shumë pakëndshëm	2	3	4	5	6	7	8	9	Krejtësisht këndshëm	Indif.	Nuk e di (NUK LEXOHEJ)
Q8_1 Grua	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_2 Me orientim të ndryshëm seksual (gej burrë ose grua lesbike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_3 Person me përkatësi etnike të ndryshme nga ajo e shumicës	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_4 Person me i ri se 30 vjeç	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_5 Person me përkatësi religjioze të ndryshme nga ajo e shumicës	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_6 Person me handicap (aftësi të kufizuar mendore ose fizike)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_7 Person nga parti politike që nuk merr pjesë në qeveri	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99
Q8_8 Person më i vjetër se 75 vjeç	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	99

SHOUKARTA Q9

Q9. A do të ishit pajtuar ose do të kishit qenë kundër hyrjes në fuqi të masave specifike për sigurimin e mundësive të barabarta për punësim të të gjithë personave? Për shembull, kësi lloj masash janë: programe speciale për trajnim ose kuota për punësim të personave bazuar në...

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NË SECILIN RRESHT	Krejtësisht pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Pjesërisht jam kunder	Krejtësisht jam kunder	Nuk e di (NUK LEXOHET)
Q9_1 Përkatësi etnike	1	2	3	4	9
Q9_2 Gjini	1	2	3	4	9
Q9_3 Moshë	1	2	3	4	9
Q9_4 Religjion apo bindje	1	2	3	4	9
Q9_5 Handikap (af- tësia e kufizuar mendore ose fizike)	1	2	3	4	9
Q9_6 Orientimi seksual	1	2	3	4	9
Q9_7 Përkatësi par- tiake	1	2	3	4	9

SHOUKARTA Q10

Q10. Deri në cilën masë pajtoheni ose do të kishit qenë kundër që në vendin e punës të zbatohen këto sende?

LEXONI, ROTONI NJË PËRGJIGJE NË SECILIN RRESHT	Krejtësisht pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Pjesërisht jam kundër	Krejtësisht jam kundër	Nuk e di (NUK LEXOHET)
Q10_1 Të evidentohet përbërja e të punësuarve që të mund të ndiqet dhe të vlerësohet sa janë të përfshirë pjesëtarët e komuniteteve etnike më të vogla	1	2	3	4	9
Q10_2 Të ndiqen procedurat për punësim me qëllim që personave që u përkasin komuniteteve etnike më të vogla, t'u sigurohen mundësi të barabarta për t'u pranuar në punë, si kandidatëve të tjerë me shkathtësi apo kualifikime të ngjashme.	1	2	3	4	9

SHOUKARTA Q11

Q11. Marrë në përgjithësi, a do të mund të thoshit se bëhen përpjekje të mjaftueshme për luftë kundër të gjitha llojet e diskriminimit në shtet?

LEXONI VETËM NJË PËRGJIGJE	
Bëhen përpjekje me të vërtetë	2
Bëhen përpjekje deri në ndonjë masë	3
Nuk bëhen përpjekje me të vërtetë	4
Nuk bëhen asnjëfarë përpjekjesh	
Nuk e di (NUK LEXOHE)	9

Q12. A e dini se cilat janë të drejtat e juaja në qoftë se jeni viktimë e diskriminimit?

LEXONI	
Po	1
Jo	2
Tjetër (shkruaj)	3
Nuk e di (NUK LEXOHE)	9

Q13. Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose shqetësimit, a do të kërkonit mbrojtje nga institucionet përkatëse, organizatat?

LEXO		
Jo	KALO NE Q1_1	1
Po	KALO NE Q14	2
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)	KALO NE Q1_1	9

PERGJIGJEN ATA TË CILËT NË Q13 JANË
PERGJIGJUR ME OPSIONIN 2

Q14. Ku do te drejtoheni për të kërkuar mbrojtje? Po në vend tjetër? Ndonjë tjetër?

MOS LEXO PERGJIGJET

		Q14,a I pari i përmendur	Q14,b Tjetër
1	Gjyq		
2	Polici		
3	Avokati i Popullit		
4	Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi		
5	Avokatë		
6	Sindikatë		
7	Organizata qytetare		
8	Tjetër (shëno)		
9	Nuk e di/Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOJET)		

PYETI TË GJITHË

Q1_1 A keni shok apo të njohur/a të cilët janë...?

LEXONI NJË PËRGJIGJE NË SECILIN RRESHT	Po	Jo	Nuk e di (NUK LEXOJET)
Q1_1_1 Pjesëtarë të ndonjë bashkësie tjetër etnike	1	2	9
Q1_1_2 Rom	1	2	9
Q1_1_3 Me orientim të ndryshëm seksual (gej burrë apo lezbike)	1	2	9
Q1_1_4 Persona me handikap (aftësi e kufizuar mendore ose fizike)	1	2	9
Q1_1_5 Persona me religjion apo bindje të ndryshme nga ato të tuajat	1	2	9
Q1_1_6 Pjesëtarë të partive politike me qëndrimet e të cilëve nuk pajtoheni	1	2	9

Q1_2 A mendoni se ne vendin ku jetoni, i takoni diçkaje nga ajo qe vijon? Ju lutem t'i shënoni te gjitha për te cilat mendoni se janë relevante.


LEXONI; ROTONI MË SHUMË PËRGJIGJE JANË TË MUNDSHME		
Q1_2_1	Pakice etnike	1
Q1_2_2	Pakice në bazë të përkatësisë religjioze	2
Q1_2_3	Pakice seksuale	3
Q1_2_4	Pakice në bazë të handicapit (aftësi e kufizuar mendore ose fizike)	4
Q1_2_5	Pakice në bazë të përkatësisë politike apo simpatizimit partiak	5
Q1_2_6	Asnjëra nga te cekurat	6
Q1_2_7	Një grup tjetër pakice shkruaj	7
Q1_2_99	Nuk e di (NUK LEXOHEJ)	99

Shtojca 3 -

Shpërndarja e karakteristikave socio-demografike relevante të të anketuarëve/ave

	2009	2013	2018
	%	%	%
Gjinia:			
Mashkull	50.3	50.0	49.8
Femër	49.7	50.0	50.2
Grup moshat			
15-24	20.5		15.7
25-34	18.9		18.8
35-44	18.9		17.8
45-54	16.6		16.6
55-64	11.7	14.8	15.2
65+	13.4	12.3	15.9
Arsimi			
Fillor	35.8	17.7	24.2
Të mesëm	49.7	53.3	49.9
Më të lartë	14.5	29.0	26.0
Përkatësisë etnike			
Maqedonas/e	67.0	69.1	63.4
Shqiptar/e	22.9	24.8	25.9
Turk/e	2.8	1.4	3.6
Vlleh/e	0.9	0.6	0.1
Rom/e	3.1	1.1	3.2
Serb/e	1.8	1.5	1.7
Tjetër	1.6	1.5	2.1
Religjion			
Krishter	69.1		65.0
Mysliman	29.5		34.2
Ateist	0.9		0.5
Tjetër	0.5		0.2
Stausi i punës			
I/E punësuar me orar të plotë të punës	28.7		40.3
I/E punësuar me orar të shkurtë të punës	1.7		2.2
I/E papunësuar	28.2		17.9

Amvisë	12.3		11.3
Student/nxënës	11.5		8.4
Pensionist	16.9		18.6
Profesion			
I vetëpunësuar. zejtar	12.6		19.6
Udhëheqës. shef. menaxher. drejtor	8.1		4.3
Nëpunës me arsim më të lartë	19.9		19.4
Nëpunës me arsim të mesëm	12.0		9.4
Punëtor i kualifikuar me arsim të mesëm	29.7		26.8
Punëtor	14.9		15.1
Polici. armata	1.8		1.7
Bujk. fermer	0.3		3.1
Tjetër	0.8		0.5
Vendbanimi			
Rural	42.4	37.9	43.2
Urban	57.6	62.1	56.8
Rajoni			
Vardarit	7.9	7.1	7.4
Lindor	9.2	9.0	8.7
Jugperëndimor	10.9	10.0	10.8
Juglindor	8.3	8.9	8.4
Pellagonisë	11.6	10.9	11.3
Pollogut	14.2	16.0	15.5
Verilindor	8.4	8.9	8.4
Shkupit	29.4	29.1	29.5



Misioni i OSBE-së në Shkup
Bulevardi 8 shtatori nr. 16
1000 Shkup

Telefoni: +389 2 323 4000
Fax: +389 2 323 4234
Info-MK@osce.org